

Dr. ABDULLAH NABOLLI

XHUMAJA

Festa e Myslimanëve

VEÇORI DHE VLERA
RREGULLA DHE UDHËZIME

Dr. ABDULLAH NABOLLI

XHUMAJA

Festa e Myslimanëve

VEÇORI DHE VLERA
RREGULLA DHE UDHËZIME

Titulli i librit:

Xhumaja - Festa e Myslimanëve

Veçori dhe vlera – rregulla dhe udhëzime

Përgatiti:

Dr. Abdullah Nabolli

Redaktimi gjuhësor:

Qani Sulku

Ballina & Faqosja

Pelegrini




Botimi i parë

Tiranë, 2019

Përmbajtja

Parathënie	5
Ndarja e kohës në javë	7
Një ditë feste në javë për përkujtimin e Allahut	10
Xhumaja, festa javore e këtij ymeti	14
Emërtimi i ditës së xhuma dhe zanafilla e saj	18
Veçoritë e ditës së xhuma	21
Dita e xhuma në ahiret	29
Gjykimi i namazit të xhumasë	33
<i>Kategoritë e njerëzve që nuk e kanë detyrë vajtjen në xhuma</i>	35
<i>A janë kushtet e vështira të motit justifikim për lënien e xhumasë?</i>	36
<i>Sa duhet të jetë numri minimal i njerëzve, për të mbajtur një xhuma?</i>	38
Përgatitja për xhuma	39
<i>1- Përkushtimi ndaj namazit të sabahut të ditës së xhuma dhe leximi i disa pjesëve të veçanta të Kuranit gjatë tij.</i>	39
<i>2- Leximi i sures El-Kehf gjatë ditës së xhuma apo natës së saj.</i>	40
<i>3- Dërgimi salavate mbi profetin Muhamed -alejhi selam-</i>	41
<i>4- Pastrimi dhe zbukurimi</i>	43
<i>5- Vajtja në xhami para se imami të ngjitet në minber.</i>	44
<i>6- Shfrytëzimi i vajtjes herët në xhami</i>	

<i>për namaz nafîle dhe ibadet</i>	46
Ezani i xhumasë	48
<i>Ligjshmëria e ezanit të Uthmanit -radiallahu anhu-</i>	52
<i>A është sot i nevojshëm ezani i Uthmanit -radiallahu anhu-?</i>	54
<i>Ç'duhet të bëjë besimtari kur thirret ezani i parë i lajmërimit?</i>	56
Koha e namazit të xhumasë	57
<i>1- Kur bashkohen festa e xhumasë me festën e Bajramit</i>	60
<i>2- Kur bën vapë</i>	60
<i>3- Kur imami ka ndërmend të udhëtojë</i>	61
Hytbja e xhumasë	62
<i>Karakteristikat e hytbes profetike</i>	63
<i>1- E fillonte me falënderimin e Allahut dhe me shehadet</i>	63
<i>2- Këshillonte me ajete dhe sure nga Kurani</i>	64
<i>3- I kushtonte rëndësi anës emocionale</i>	66
<i>4- Hytbja e tij ishte mesatare</i>	67
<i>5- Hytben e mbante në këmbë dhe e ndante atë në dy hytbe nëpërmjet një uljeje mes tyre</i>	68
<i>Si duhet të qëndrojmë gjatë hytbes?</i>	68
<i>A arrihet shpërblimi i xhumasë për atë që bën veprime të kota gjatë hytbes dhe a i quhet xhumaja atij?</i>	71
Namazi i xhumasë	74
<i>Kur arrihet namazi i xhumasë?</i>	77
<i>A kërkohet namazi i drekës për atë që ka falur xhumanë?</i>	78
<i>A ka namaz synet pas xhumasë?</i>	80
Mirësitë e përkushtimit ndaj xhumasë	81
Ora e përgjigjes së duasë (lutjes) ditën e xhuma	85
Mosrespektimi i ditës së festës dhe pasojat e tij	89



Parathënie

Lëvdatat i takojnë vetëm Allahut të madhëruar. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi profetin e Tij të fundit, Muhamedin alejhis-selam!

Sa më shumë rëndësi të kenë disa çështje në fenë e njeriut dhe sa më e madhe të jetë nevoja e tij për to, aq më shumë bëhet e nevojshme për t'i trajtuar ato në studime të veçanta të përmbledhura dhe përfshirëse për tematikat e tyre, në mënyrë që atyre t'u kushtohet rëndësia e duhur dhe njohuritë rreth tyre të jenë të plota. Kështu është vepruar me kuptimin e Shehadetit “La ilahe il-lall-llah Muhammedun resulull-llah” dhe kushtet e tij; me namazin dhe formën e faljes së tij; me mirësitë e agjërimit, zekatit dhe haxhit dhe dispozitat e tyre; me sinqeritetin dhe rëndësinë e tij; me mohimin, hipokrizinë dhe rrezikun e tyre, etj.

Një prej këtyre çështjeve të rëndësishme për besimtarët myslimanë dhe e nevojshme për të pasur njohuri të plota rreth saj është edhe xhumaja - festa e tyre javore.

Rëndësia e xhumasë shfaqet në tre këndvështrime kryesore:

1- Xhumaja është shenjë dalluese e fesë islame dhe si e tillë ajo shpreh identitetin e myslimanit dhe kërkohet prej tij ta respektojë atë.

Allahu i madhëruar, për respektimin e këtyre shenjave thotë në Kuran:

ذَلِكَ وَمَنْ يُعْظِمِ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

“Po. Kush i madhëron shenjat e fesë së Allahut, ajo është prej devotshmërisë së zemrave” suretu El-Haxh: 32.

2- Xhumaja ka veçori, mirësi, rregulla, etj, të cilat përmbajnë shpërblime dhe begati të mëdha për besimtarin, që nuk duhet t'i kalojnë pa i shfrytëzuar. Profeti -alejhi selam- thotë: **“Zoti juaj ka vënë aroma mirësie në kohën tuaj, prandaj shfaquni para tyre se ndoshta ju prek ndonjëra nga ato, e të mos brengoseni kurrë pas tyre”**. E transmeton Taberaniu dhe e saktëson sheikh Albani.

3- Xhumaja është festë javore që përsëritet shpesh gjatë muajit dhe vitit dhe sa më i shpeshtë të jetë kontakti i besimtarit me të, aq më e nevojshme është që ai të mësojë rreth saj.

Kështu, dita e xhuma është dita më e madhe e javës për myslimanët dhe angazhimet e tyre fetare përgjatë saj do të jenë gjithmonë më shumë se në çdo ditë tjetër, prandaj le të njihemi gjerësisht me të, sepse një pjesë e identitetit të tyre fetar dhe e begatisë në punët e tyre lidhet me të!

Dr. Abdullah NABOLLI



Ndarja e kohës në javë

Allahu i madhëruar, sikurse është Krijuesi i botës materiale, po ashtu është dhe Krijuesi i kohës. Ai me krijimin e diellit ndau ditën nga nata dhe kështu u krijua koha, siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran:

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ كُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ

“Allahu është Ai, i cili krijoi natën dhe ditën, diellin dhe hënën; të gjitha këto lundrojnë në gjithësi”¹.

Njësia më e vogël kryesore e matjes së kohës është dita dhe shtatë të këtilla përbëjnë një javë. Pastaj të tjerat janë përsëritje e tyre dhe nëpërmjet këtij cikli formohen muajt dhe vitet.

Grupimi i ditëve në javë ka lidhje me një realitet të vjetër historik, që është fillimi i krijimit të kësaj bote.

Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ

¹ Suretu El-Enbija: 33.

“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre, për gjashtë ditë, pastaj është ngritur mbi fron”².

Ky fakt përcjell tek ne përdorimin e parë të fjalës ditë dhe të fjalës javë, sepse java ka shtatë ditë, ku gjashtë ditë të saj janë ditët e krijimit dhe dita e shtatë është dita e lartësimit të Zotit të botëve mbi arsh. Gjashtë ditët e krijimit janë: e diela, e hëna, e marta, e mërkura, e enjta dhe xhumaja siç tregon Abdullah bin Selami -radiallahu anhu:- *“Allahu e ka filluar krijimin e tokës dhe e krijoi atë në shtatë shtresa ditën e diel dhe të hënë. Pastaj ka caktuar riskun e saj ditën e martë dhe të mërkurë. Pastaj ka synuar qiellin, të cilin e krijoi në dy ditë dhe e mbaroi atë ditën e xhuma”³.* Ndërsa ditën e shtatë që i bie dita e shtunë, nuk ka pasur në të krijim, por lartësimi i Allahut mbi arsh, siç shpjegon imam Taberiu -Allahu e mëshiroftë-⁴.

Shejhju Islam ibn Tejmija -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë fakt thotë: *“Çdo ymet që nuk ka pasur libër, nuk ka në fjalorin e tij fjalën “javë”. Ata në fjalorin e tyre kanë fjalët: ditë, muaj dhe vit, sepse ato kapen nëpërmjet shqisave dhe logjikës, prandaj dhe u kanë vënë atyre emra, sepse shprehjet pasojnë imagjinatën. Ndërsa, për sa i përket javës, ajo nuk është njohur veçse me anë të dëgjimit. Nuk e kemi ditur se Allahu ka krijuar qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe pastaj është lartësuar mbi arsh, veçse nëpërmjet lajmeve të profetëve, të cilëve u është kërkuar të mblidhen një ditë*

² Suretu Es-Sexhde: 4.

³ E transmeton El-Firjabij me zinxhir të saktë.

⁴ Shih tefsir Et-Taberij: 20/166

*në javë për ta adhuruar Allahun dhe për të ruajtur me të javën e parë të krijimit, me të cilën Allahu i madhëruar ka filluar krijimin e kësaj bote*⁵.

Pra, java simbolizon krijimin e parë dhe në të është caktuar një ditë feste që të adhurohet Allahu përgjatë saj dhe të ruhet ndarja e kohës.

⁵ Shih librin e autorit me titull Mexhmu El-Fetaua: 7/95.



Një ditë feste në javë për përkujtimin e Allahut

Një festë javore të ligjësuar nga Allahu i madhëruar për përkujtimin e Tij, e gjejmë herët në mesin e besimtarëve. Gjurmët e para të këtij zakoni i hasim te hebrenjtë, për të cilët Allahu i madhëruar thotë:

إِنَّمَا جُعِلَ السَّبْتُ عَلَى الَّذِينَ اخْتَلَفُوا فِيهِ وَإِنَّ رَبَّكَ لَيَحْكُمُ بَيْنَهُمْ
يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ

“Në të vërtetë, e shtuna u caktua (për përkujtimin e Allahut) për ata që patën kundërshti në lidhje me të. Sigurisht që Zoti yt do t’i gjykojë ata ditën e kiametit për atë çështje që nuk pajtoheshin”⁶.

Ky ajet përmban disa fakte:

I pari: Allahu ka caktuar një ditë feste në javë për besimtarët për përkujtimin e Tij.

I dyti: E shtuna është dite feste për përkujtimin e Allahut për hebrenjtë.

⁶ Suretu En-Nahl: 124.

I treti: E shtuna -si festë për hebrejnë- ka ardhur pas një kundërshtimi në lidhje me caktimin e saj.

Të gjitha këto fakte janë të qarta në ajet, sepse edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë të pranishme në mesin e njerëzve, me përjashtim të faktit të tretë, i cili ka nevojë për sqarim, sepse debati rreth tij akoma vazhdon.

Imam Taberiu në komentimin e këtij ajeti thotë: *“Nuk e ka caktuar Allahu madhërimin e të shtunës veçse për shkak të kundërshtimit të tyre: Disa thanë: Ajo (e shtuna) është dita më e madhe e javës, sepse Allahu i madhëruar e ka mbaruar krijimin ditën e xhuma dhe dita e shtunë ishte ndërprerje (mes ditës së fundit të krijimit dhe ditës së fillimit të tij). Ndërsa të tjerët thanë: Më e madhja ditë është dita e diel, sepse ajo është dita e fillimit të krijimit”*⁷.

Edhe profeti ynë Muhamedi -alejhi selam- e ka pohuar këtë kundërshtim mes tyre dhe ka thënë:

“Ne jemi të fundit (në dynja) dhe të parët ditën e kiametit, edhe pse atyre iu dha libri para nesh e neve na u dha pas tyre. Kjo është dita të cilën Allahu ua kishte obliguar (për festë), por ata ranë në kundërshtim, kurse neve na udhëzoi Allahu për në të. Ata janë pas nesh: hebrejnë e kanë nesër dhe të krishterët pasnesër”⁸.

Ky citat profetik, përveçse pohon faktin e kundërshtimit në lidhje me caktimin e të shtunës, na tregon edhe një realitet tjetër të panjohur më parë dhe që është ai i ditës së xhuma, që do të

⁷ Shih tefsir imam Et-Taberij: 17/320.

⁸ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

thotë: Allahu ua ka kërkuar atyre ditën e xhuma për festë dhe popujt që kanë njohur librat e hershëm të Allahut, për shkak të debateve të tyre me profetët janë orientuar te ditë të tjera dhe jo te dita të cilën e kishte kërkuar Allahu i madhëruar.

Ibn Kethiri (komentuesi i njohur i Kuranit -Allahu e mëshiroftë-) në lidhje me këtë çështje thotë: *“Thuhet se Allahu i madhëruar, xhumanë ua kishte caktuar (për festë) Beni Israilëve nëpërmjet Musait -alejhi selam-, mirëpo ata e shmangën atë dhe zgjodhën të shtunën, sepse ajo është dita në të cilën Allahu nuk ka krijuar gjë prej krijesave, pasi që e kishte plotësuar krijimin e tyre ditën e xhuma. Pastaj Allahu i madhëruar ua bëri detyrë atë (dmth: ua dha të shtunën për festë, edhe pse ajo nuk ishte dita e kërkuar) në ligjet e Teuratit. Ai i porositi që të kapen fort pas saj dhe ta ruajnë mirë atë, duke i porositur njëkohësisht dhe për pasim të Muhamedit -alejhi selam- kur Ai ta dërgonte atë profet dhe u mori atyre besën për këtë”*.

Pastaj Ibn Kethiri -Allahu e mëshiroftë- shton: *“Ata (hebrenjtë) vazhduan ta ruajnë këtë zakon derisa Allahu dërgoi Isain, të birin e Merjemes -alejhi selam-. Thuhet se ai ua ndërroi atë me të dielën, mirëpo thuhet gjithashtu se, ai nuk e ka lënë ligjin e Teuratit, më përjashtim të atyre ligjeve që ia anuloi Allahu i madhëruar dhe se ai ka vazhduar ta respektojë të shtunën derisa e ngriti Allahu lart, por të krishterët pas tij në kohën e Kostandinit (mbreti i parë romak i krishterë) janë ata të cilët e ndërruan atë me të dielën për të kundërshtuar hebrenjtë, siç u drejtuan dhe nga lindja në lutjet e tyre në vend të shkëmbit (në xhaminë e Aksasë) dhe Allahu e di më së miri!”⁹*

⁹ Shih tefsirin e Ibn Kethirit: 4/612.

Këtë realitet, të cilin e përcjellin citatet e Kuranit, të hadithit dhe librat e historisë, na konfirmojnë caktimin e një dite festë javore për besimtarët, siç edhe na tregojnë për rëndësinë e ditës së xhuma, të cilën nuk e patën fat ymetet e mëparshme për ta pasur festë dhe se atë fat e pati Muhamedi -alejhi selam- dhe pasuesit e tij deri në ditën e gjykimit.



Xhumaja, festa javore e këtij ymeti

Fjala festë apo “**el-ijd**” në gjuhen arabe, nuk përdoret në fjalët e profetit -alejhi selam- veçse për një ditë që ka këto veçori:

1- Të jetë ditë e zgjedhur nga Allahu i madhëruar, sepse madhërimi i ditëve është e drejtë e krijuesit të tyre siç thuhet në Kuran:

وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ سُبْحَانَ اللَّهِ وَتَعَالَى
عَمَّا يُشْرِكُونَ

“Zoti yt krijon ç’të dojë dhe zgjedh. Nuk u takon atyre të zgjedhin. I lartmadhëruar është Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij!”¹⁰.

2- Të jetë ditë me vlerë te Allahu i madhëruar, sepse prej cilësive të Krijuesit të gjithësisë është urtësia, dhe kështu që, kur Ai zgjedh diçka, zgjedh atë që ka vlerë siç ka zgjedhur ditën e Fitrit dhe të Kurbanit. Dita e Fitrit është dita e çeljes së madhe pas muajit të

¹⁰ Suretu El-Kasas: 68.

agjërimet, ndërsa dita e Kurbanit është dita e ndjekjes së gjurmëve të Ibrahimit në adhurimin e Allahut një, pa i shoqëruar Atij ortakë.

3- Të jetë ditë në të cilën madhërohet Allahu i lartësuar dhe në të cilën shfaqet gëzimi, siç duket qartë te festa e Fitrit dhe e Kurbanit, sepse në to ka, edhe madhërime të Allahut me dhikr dhe namaz, edhe shfaqje gëzimi me zbukurime, ushqime, etj.

4- Të jetë angazhim që përsëritet, sepse me fjalën “**el-ijd**” emërtohen ato zakone që përsëriten herë pas here te njerëzit.

Xhumanë me karakteristikat e lartpërmendura, si festë javore të këtij ymeti, e gjejmë të shënuar edhe në Kuran, edhe në hadithet profetike.

Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ

“O ju që keni besuar, kur të thirret për në namaz ditën e xhuma, nxitoni për në përkujtimin e Allahut dhe lëreni tregtinë!”¹¹.

Imam Ibn Kethiri -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë ajet thotë: «*Allahu i madhëruar i porositi besimtarët që të mbliidhen për adhurimin e Tij ditën e xhuma dhe fjala e Tij “**nxitoni**” dmth: përkushtohuni për të vajtur në vendin ku mbahet ajo!*»¹².

Ndërsa me fjalën “festë”, xhumaja është cilësuar në hadithet

¹¹ Suretu El-Xhumuah: 9.

¹² Shih tefsir Ibn Kethir: 8/120.

profetike siç tregon Ibn Abasi -radiallahu anhuma- se profeti alejhi selam ka thënë:

“Kjo është një ditë feste të cilën Allahu e ka bërë për myslimanët. Kush vjen për në xhuma, le të lahet! Nëse ka parfum, le të parfumoset! Dhe të përdorë misvakun”¹³.

Kështu, kësaj dite i janë dhënë të gjitha karakteristikat që kanë dy festat e mëdha: Fitri dhe Kurhani si: pastrimi, bashkimi, namazi dhe ligjërata. Madje nuk është lejuar as agjërimi i saj, siç nuk lejohet as agjërimi i dy festave të mëdha.

Profeti -alejhi selam- thotë: **“Të mos e agjërojë askush ditën e xhuma, veçse nëse shoqërohet me një ditë tjetër agjërimi, para saj ose pas saj!”¹⁴.**

Dijetari i njohur Ibn Hubejra i kohës së dinastisë Abasite -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë hadith thotë: *“Kjo, sepse dita e xhuma ka angazhime dhe rite dhe agjëruesi mund të mos ketë mundësi t'i kryejë. Ajo -në këtë këndvështrim- i ngjan ditës së Arafatit (e cila nuk agjërohet nga haxhinjtë). Dhe për shkak se Allahu i madhëruar, përderisa ka porositur për pastrim, zbulurim dhe mbledhje, i ngjan në këtë këndvështrim ditëve të festave dhe, nëse njeriu agjëron, kundërshton me veprën e tij qëllimin për të cilin është caktuar kjo ditë, mirëpo nëse agjërohet ose një ditë para, ose një ditë pas, del nga kjo gjë e papëlqyer, sepse në këtë rast nuk e ka veçuar atë me adhurim”¹⁵.*

¹³ E transmeton Ibn Maxhe dhe e saktëson sheikh Albani.

¹⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹⁵ Shih librin e autorit me titull “El-Ifsah an meanij Es-Sihah”: 6/351.

Ebu Dherri -radiallahu anhu- i këshillonte disa tabi'inë kur i shihte me agjërim ditën e xhuma, duke u thënë: *“Ju lutem, për hir të Allahut çeleni, se kjo ditë është ditë feste”*¹⁶.

¹⁶ E transmeton Ibn Ebij Shejbe dhe e saktëson sheikh Albani.



Emërtimi i ditës së xhuma dhe zanafilla e saj

Emri [**el-xhumuah**] në arabisht, apo [**e xhuma**] në shqip është emër islam, sepse ky emër nuk ka qenë njohur para islamit.

Emri i hershëm i xhumasë tek arabët ka qenë [**el-urubeh**] siç është edhe emri [**e premte**] te shqiptarët.

Ensarët, (siç quhen banorët myslimanë të Medinës në kohën e profetit -alejhi selam-) kanë qenë të parët në islam që kanë falur xhumanë dhe po ata e kanë quajtur atë [**el-xhumuah**], që do të thotë mbledhje apo grumbullim, sepse njerëzit në këtë ditë mblidhen për të përkujtuar Allahun e madhëruar.

Muhamed bin Sirini (dijetar i madh në kohën e tabi'inëve, i cili vdiq në vitin 110 sipas hixhretit -Allahu e mëshiroftë-) thotë: «Banorët e Medinës, para ardhjes së profetit alejhi selam dhe para se të bëhej detyrë xhumaja, ishin ata të cilët e quajtën këtë ditë [*e xhuma*].

Ensarët në atë kohë, thanë: hebrenjtë kanë një ditë, në të cilën bashkohen në çdo shtatë ditë dhe po ashtu edhe të krishterët. Të caktojmë dhe ne një ditë, në të cilën të përkujtojmë Allahun, të falemi dhe ta falënderojmë Atë.

Ata thanë: Dita e shtunë është e hebrenjve, dita e diel është e të krishterëve, atëherë të caktojme ditën el-urube -sepse ata e quanin ditën e xhuma, el-urube-.

Kështu, ata u mbloodhën në shtëpinë e Es'ad bin Zurara dhe ai atë ditë u fal me ta dhe i këshilloi. Ata e quajtën këtë ditë [el-xhumuah] (dita e mbledhjes) dhe kur u mbloodhën te Esad bin Zurara, ai u theri atyre një dele dhe ata hëngrën dy vakte me të, sepse ishin pak.

Allahu për këtë rit, zbriti më pas ajetin:

إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ

“Kur të thirret për në namaz ditën e xhuma, shpejtoni për në përkujtimin e Allahut”»¹⁷.

Ibn Khajimi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë ngjarje thotë:

“Ky ishte fillimi i xhumasë. Pastaj, kur profeti -alejhi selam-emigroi dhe arriti në afërsi të Medinës, qëndroi në Kuba (vend afër Medines) te fisi Beni Amr bin Auf, siç tregon historiani i njohur Ibn Is'haku -Allahu e mëshiroftë-.

Ai qëndroi atje nga e bëna deri të enjten dhe aty themeloi xhaminë e tyre (xhaminë e Kubasë). Pastaj paraditen e xhumasë, doli prej tyre (në drejtim të Medines) dhe e zuri koha e faljes së xhumasë te fisi Beni Salim bin Auf dhe e fali atë në xhaminë e asaj lugine.

Ajo xhuma ka qenë xhumaja e parë që i dërguari i Allahut -alejhi selam- ka falur në Medine para se të themelohej xhamia e Medines”¹⁸.

¹⁷ E transmeton Abdurrazaku me zinxhirë të saktë.

¹⁸ Shih librin Zad El-Mead: 1/362.

Një tabi'in i njohur që quhet Ebu Seleme bin Abdurrahman bin Auf -Allahu e mëshiroftë- i cili vdiq në vitin 94 apo 104 sipas hixhretit, na tregon për fjalët e hytbes së parë të profetit -alejhi salam- në Medine.

Ai thotë: “Në hytben e parë që ka mbajtur profeti -alejhi salam- në Medine, u ngrit mes njerëzve, e falënderoi Allahun, e lavdëroi Atë dhe tha:

O njerëz! Bëni vepra të mira për veten tuaj! Dijeni se, pasha Allahun, ndonjërin prej jush ka për ta kapluar kllapia (*e orës së fundit të dynjasë*) dhe do ta lërë bagëtinë e tij pa bari. Pastaj do ta pyes Zoti i tij pa përkthyes dhe pa pengesa mes tij dhe Atij dhe do t'i thotë: A nuk të ka ardhur profeti im dhe t'i përcollti porosinë e mia?! A nuk të dhashë pasuri dhe të mbulova me mirësitë e mia?! Atëherë çfarë ke punuar për veten tënde?

Ai do të vështrojë nga e djathta dhe e majta (*për të parë se çfarë mund të sjellë*) dhe nuk do të shohë asgjë. Pastaj do të vështrojë përpara dhe nuk do të shohë gjë tjetër përveç xhehenemit.

Kush ka mundësi ta ruaj veten e tij prej zjarrit, qoftë edhe me një gjysmë hurme (*sadaka*), le ta bëjë atë! Dhe kush nuk ka as aq, atëherë me një fjalë të mirë, sepse vepra e mirë shpërblehet me dhjetë të mira si ajo, deri në shtatëqind fish.

Selami qoftë mbi ju dhe mbi të dërguarin e Tij, gjithashtu dhe mëshira e Allahut dhe begatia e Tij!¹⁹

¹⁹ E transmeton Bejhakiu me zinxhir të saktë deri te Ebu Selemja -Allahu e mëshiroftë-.



Veçoritë e ditës së xhuma

Kurani dhe hadithet profetike tregojnë për disa veçori të ditës së xhuma, të cilat e dallojnë atë nga ditët e tjera. Prej këtyre veçorive përmendim:

1- Xhumaja është ditë në të cilën është betuar Allahu i madhëruar

Në Kuranin kerim (famëlartë) thuhet:

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ * وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ * وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ

“Pasha qiellin me yje! Ditën e premtuar! Atë që dëshmon dhe atë që prezantohet”²⁰.

Në këtë ajet ka katër betime. Allahu i madhëruar, kur betohet në një gjë, tregon se ajo ka vlerë tek Ai. Njëri për këtyre betimeve ka të bëjë me ditën e xhuma, siç tregon Ebu Hurejra -radiallahu anhu- se profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Dita e premtuar është dita e kiametit. Dita që prezantohet është dita e Arafatit. Ndërsa dita që dëshmon është dita e xhuma”²¹.

²⁰ Suretu El-Buruxh: 1-3.

²¹ E transmeton Tirmidhiu dhe e saktëson sheikh Albani.

Komentuesit e Kuranit mendojnë se dita e xhuma është quajtur dita që dëshmon, sepse ajo dëshmon për ata që e falin namazin e xhumasë, përkujtojnë Allahun dhe i luten Atij në këtë ditë.

2- Xhumaja është dita më e mirë e javës

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti alejhi selam ka thënë:

“Më e mira ditë në të cilën ka lindur dielli është dita e xhuma. Në këtë ditë është krijuar Ademi, në këtë ditë ai ka hyrë në xhenet, në këtë ditë ka dalë prej tij dhe nuk do të ndodhë dita e kiametit veçse ditën e xhuma”²².

Në këtë hadith njoftohemi se xhumaja është më e mira ditë dhe duke qenë se kjo mirësi është pohuar edhe për ditën e Kurbanit, siç ka ardhur në një hadith tjetër: **“Dita më e madhe te Allahu është dita e Kurbanit”²³**, atëherë lind pyetja: Cila nga të dyja është më e mirë?

Është pyetur shejkhu islam Ibn Tejmija –Allahu e mëshiroftë-se cila ditë është më e mirë, xhumaja apo dita e Kurbanit?

Ai është përgjigjur: *“Dita e xhuma është më e mira ditë e javës, kurse dita e Kurbanit është dita më e mirë e vitit”²⁴.*

Mirësia e kësaj dite sipas hadithit, vjen nga disa ngjarje të rëndësishme, të cilat, ose kanë ndodhur, ose do të ndodhin në të ardhmen e historisë së njerëzimit dhe që ia shtojnë asaj veçoritë.

²² E transmeton Muslimi.

²³ E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

²⁴ Shih fjalët e autorit në librin “Mexhmu El-Fetaua”: 25/288.

3- Në ditën e xhuma është krijuar Ademi -alejhi selambabai i njerëzimit

Pra, dita e xhuma ka lidhje të ngushtë me njeriun, sepse ajo i kujton atij zanafillën e tij, siç i kujton atij dhe cilësinë më specifike të Zotit të tij, cilësinë e krijimit, pa të cilën ai nuk do të kishte ardhur në këtë botë.

4- Në ditën e xhuma ka hyrë në xhenet Ademi -alejhi selam-

Pra, dita e xhuma i kujton njeriut xhenetin, vendin e tij fillestar, vendi në të cilin janë fshëhur mirësitë e Allahut dhe se njeriu është krijuar për të qenë banor i këtij vendi.

5- Në ditën e xhuma ka dalë nga xheneti Ademi -alejhi selam-

Kjo ditë i kujton njeriut se ç'pasoja të rënda vijnë nga kundërshtimi i Allahut, Zotit të tij dhe se ai vendin e tij në xhenet mund ta humbasë nëse kundërshton Atë. Kjo gjë e bën njeriun të jetë më i kujdesshëm në jetën e tij, sepse, nëse ai e humbi njëherë xhenetin me daljen e Ademit prej tij, atëherë të mos e humbasë sërish në të njëjtën mënyrë.

6- Në ditën e xhuma do të bëhet kiameti

Kështu, dita e xhuma është dita e fundit e kësaj bote dhe ajo i kujton besimtarit mbylljen e historisë njerëzore dhe ciklit të saj, të filluar me Ademin -alejhi selam-, për të kaluar më pas në botën e ahiretit, botën e llogarisë e të shpërblimit.

Në një hadith tjetër, në lidhje me këtë veçori, thuhet: **“Në këtë ditë (dmth: në ditën e xhuma) është fryrja e surit dhe në të është kllapia”²⁵.**

Fryrja e surit është fillimi i kiametit, kurse kllapia është ajo që e shoqëron fryrjen e surit për shkak të së cilës bie i vdekur çdo gjë në qiell dhe në tokë, përveç Allahut të madhëruar.

Disa veçori të tjera përmenden në një transmetim tjetër të hadithit, të Ebu Hurejrës -radiallahu anhu-. Ai thotë se profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Më e mira ditë në të cilën ka lindur dielli është dita e xhuma. Në këtë ditë është krijuar Ademi, në këtë ditë ka zbritur nga xheneti, në këtë ditë, atij i është pranuar pendimi, në këtë ditë ka vdekur dhe në këtë ditë ka për t’u bërë kiameti. Prandaj, nuk ka ndonjë gjë që lëviz në tokë, veçse dëgjon me vëmendje që nga koha e agimit deri në lindje të diellit nga frika e orës së fundit të dynjasë me përjashtim të xhinëve dhe njerëzve. Dhe në të ka një orë gjatë së cilës, kushdo që qëllon duke u lutur, Allahu ia jep atë që do”²⁶.

Sipas këtij transmetimi, veçorive të ditës së xhuma i shtohen edhe katër veçori të tjera.

7- Në ditën e xhuma, i është pranuar pendimi Ademit alejhi selam

²⁵ E transmeton Ebu Daudi, Ibn Maxhe dhe e saktëson sheikh Albani.

²⁶ E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

Pra, kjo ditë i kujton besimtarit se, sa herë që mund të bjerë në ndonjë gabim për shkak të natyrës së tij njerëzore të gabueshme, Zoti i tij ia pranon pendimin, siç ia ka pranuar babait të tij të parë Ademit -alejhi selam- dhe se njeriu i ka portat e pendimit të hapura, sado i madh të jetë gabimi i tij.

8- Ditën e xhuma ka vdekur Ademi -alejhi selam-.

Pra, kjo ditë gjithashtu i kujton besimtarit, jo vetëm ndarjen e përhershme të njerëzimit nga kjo botë, por edhe ndarjen e veçantë të çdo njeriu dhe shpëputjen e tij prej saj për të hyrë në botën tjetër të varrit, e cila i paraprin ringjalljes dhe llogarisë.

Jemi njoftuar se vdekja e Ademit -alejhi selam- në këtë ditë është dëshmi për të dhe për çdo mysliman që vdes në këtë ditë. Abdullah bin Amri -radiallahu anhu- tregon se i Dërguari i Allahut -alejhi selam- ka thënë:

“Nuk ka ndonjë mysliman që vdes ditën e xhuma, ose natën e xhuma, veçse Allahu i madhëruar ka për ta ruajtur nga sprova e varrit”²⁷.

9- Ditën e xhuma i frikësohet kiametit çdo gjë që lëviz në tokë nga agimi i saj gjer në lindjen e diellit.

Pra, në këtë ditë, nëse dielli lind dhe nuk ndodh kiameti, kjo për besimtarin do të thotë se Allahu i madhëruar i ka dhënë atij përsëri afat, për t'i rregulluar marrëdhëniet me Zotin dhe se të paktën rreziku i saj për një javë ka kaluar. Kjo në vetvete përbën

²⁷ E transmeton Ahmed, Termidhiu dhe e saktëson sheikh Albani.

një mirësi të madhe për të, sepse për një javë njeriu mund të ndryshojë shumë gjëra. Ka pasur prej njerëzve që i kanë rregulluar lidhjet e tyre me Allahun dhe e kanë fituar xhenetin e Tij në një afat kohor më pak sesa kaq, madje dhe brenda një dite të vetme.

10- Në ditën e xhuma ka një orë të veçantë ku pranohet lutja

Pra, në këtë ditë shpalolet edhe mëshira e Zotit të botëve për t'i dhënë çdokujt që i lutet Atij, atë që do. Kjo veçori shërben si një mundësi e mirë për besimtarin për t'i kërkuar Zotit të tij mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit.

Një veçori tjetër është përmendur te një hadith tjetër i Ebu Hurejres -radiallahu anhu-i cili është përmendur edhe pak më lart, ku tregohet se profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Ne jemi të fundit (*në dynja*) dhe të parët ditën e kiametit, edhe pse atyre iu dha libri para nesh e neve na u dha pas tyre. Kjo është dita të cilën Allahu ua kishte obliguar (*për festë*) por ata ranë në kundërshtim, kurse neve na udhëzoi Allahu për në të. Ata janë pas nesh: hebrenjtë e kanë nesër dhe të krishterët pasnesër”²⁸.

Kështu, numri i veçorive të ditës së xhuma shtohet edhe me një veçori tjetër dhe që është:

11- Dita e xhuma është ditë e kërkuar për adhurimin e Allahut prej mbarë njerëzimit

Kjo veçori për besimtarin do të thotë shumë dhe ja tre domethënie prej tyre!

²⁸ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

E para: Allahu i madhëruar e do adhurimin në këtë ditë, sepse, sikur të mos ishte kështu, nuk do t'ia kishte kërkuar atë të gjithë popujve. Kur besimtari është në dijeni të këtij realiteti, e di se Zoti i tij kur e do diçka e begaton atë dhe kjo do ta shtyjë atë t'i kushtojë kësaj dite rëndësi të veçantë dhe të shpresojë prej Tij mirësi të mëdha.

E dyta: Kundërshtimet e mësimëve profetike bëjnë që të humbasë mirësia nga koha e njerëzve, siç e humbën popujt e mëparshëm ditën e xhuma dhe përfunduan te ditë të tjera.

E treta: Kapja fort pas mësimëve profetike është çelësi i suksesit të këtij ymeti, i cili njihet si ymeti i bindjes dhe jo i kundërshtimit, sukses të cilin e pamë që tek fakti se si Allahu i madhëruar i frymëzoi sahabët e Medines të zgjedhin këtë ditë për adhurimin e Tij, edhe pse profeti Muhamed -alejhi selam- nuk ishte në mesin e tyre.

Për shkak të veçorive të lartpërmendura, zgjedhja e xhumasë nga ky ymet u bë shkak zilie për popujt e tjerë ndaj tij, sepse ata ia dinin asaj vlerën dhe për këtë profeti alejhi selam ka thënë:

“Ata nuk na kanë zili për ndonjë gjë, aq sa na kanë zili për ditën e xhuma, për të cilën Allahu na udhëzoi ta marrim për festë dhe i humbi të tjerët prej saj dhe për shprehjen tonë pas imamit “Amin”!”²⁹.

Ja pra, kjo është dita e xhuma! Nuk ka ditë feste në këtë botë që mund të mbledhë kaq shumë veçori. Ato, edhe nëse mbledhin veçori të vëna nga njerëzit, kurrë nuk do t'i kenë këto vlera tek

²⁹ E transmeton Imam Ahmedi dhe e saktëson sheikh Albani.

Allahu i madhëruar dhe aq më tepër begatinë e Tij, sepse Ai begaton atë që do siç thuhet në Kuran:

وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ سُبْحَانَ اللَّهِ وَتَعَالَى
عَمَّا يُشْرِكُونَ

“Zoti yt krijon çfarë të dojë dhe zgjedh. Nuk u takon atyre zgjedhja. I lartësuar qoftë Allahu nga ajo që i shoqërojnë”³⁰.

³⁰ Suretul-Kasas: 68.



Dita e xhuma në ahiret

Në ahiret, pavarësisht se nuk ka diell dhe hënë, jemi njoftuar se ka ndarje të kohës. Sheikhul Islam Ibn Tejmija -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë:

«Pas kiametit ka ndarje të kohës, sepse Allahu i madhëruar në lidhje me xhenetin thotë:

وَلَهُمْ رِزْقُهُمْ فِيهَا بُكْرَةً وَعَشِيًّا

“Ata (banorët e xhenetit) do të kenë furnizimin e tyre në mëngjes dhe mbrëmje”³¹.

Në xhenet është gjithashtu dhe dita e xhuma, dita e shtesës. Pra, atje ka ditë të dallueshme, por me shenja të tjera, të cilat i ka bërë Allahu në xhenet përveç diellit dhe hënës»³².

Në një citat tjetër, ai thotë: *“Koha atje njihet me drita të tjera dhe është transmetuar se ato shfaqen nga poshtë arshit. Pra, koha atje është aq sa zgjat intervali i shfaqjes së atyre dritave”³³.*

³¹ Suretu Merjem: 62.

³² Shih fjalët e autorit të libri “Es-Safedije”: 2/137.

³³ Shih fjalët e autorit të libri “Mexhmu El-fetaua”: 2/494.

Pra, vlerat e xhumasë do të vazhdojnë të jenë edhe në ahiret dhe ato do të jenë posaçërisht për besimtarët si nderim për ta nga Allahu i madhëruar. Prej veçorive të kësaj dite, të cilat i kanë dhënë asaj vlerë në ahiret, janë:

1- Ditën e xhuma, Allahu i madhëruar viziton banorët e xhenetit dhe ata atë ditë e shohin Zotin e botëve pa perde.

Enes bin Maliku -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Më ka ardhur Xhibrili me një pasqyrë të bardhë në mesin e së cilës kishte një pikë të zezë.

Unë e pyeta atë: O Xhibril, ç’është kjo? Ai më tha: Kjo është xhumaja, të cilën Allahu e ka bërë festë për ty dhe ymetin tënd dhe ju jeni para hebrenjve dhe të krishterëve. Në këtë ditë është një orë, në të cilën nuk qëllon njeri duke iu lutur Allahut për ndonjë të mirë, veçse Allahu i madhëruar ia jep atij.

E pyeta: Ç’është kjo e zezë (në mesin e saj)? Ai më tha: Ajo është kiameti që do të bëhet ditën e xhuma dhe ne këtë ditë e quajmë “dita e shtesës”.

E pyeta: Ç’do të thotë dita e shtesës? Ai më tha: Allahu ka bërë në xhenet një luginë të gjerë me grumbuj misku të bardhë. Ditën e xhuma, Allahu zbret në atë luginë dhe atje vihen minbere floriri për profetët, karrige prej perlash për dëshmorët dhe zbresin hyritë nga banesat e larta të xhenetit. Atëherë ata e lëvdojnë dhe e madhërojnë Allahun. Pastaj Allahu thotë: Vishini robtë e mi! Dhe atyre u jepen rroba. Ushqejini robtë e mi! Dhe atyre u jepet ushqim. Jepuni të pijnë robëve

të mi! Dhe atyre u jepet pije. Parfumosni robtë e mi! Dhe ata i parfumosin. Pastaj Allahu u thotë: Çfarë doni tjetër? Ata i thonë: O Zoti ynë! Duam që të jesh i kënaqur me ne! Atëherë Allahu u thotë: Unë jam i kënaqur me ju. Pastaj Ai urdhëron për largim dhe hyritë ngjiten në banesat e larta që janë nga smeraldi jeshil dhe rubini të kuq³⁴.

Abdullah bin Mes'udi -radiallahu anhu- në disa prej thënieve të tij tregon se, afërsia e banorëve të xhenetit nga Allahu atë ditë do të jetë sa afërsia e tyre me imamin ditën e xhuma. Ai thoshte: **“Shpejtoni për në xhuma, sepse Allahu i Madhëruar u shfaqet banorëve të xhenetit çdo ditë xhumaje dhe afërsia e tyre me Të varet nga përshpejtimi i tyre në dynja për në xhuma**³⁵.

2- Dita e xhuma është ditë tregu për banorët e xhenetit

Enes bin Malik -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi salam- ka thënë: **“Në xhenet ka një treg, ku banorët e xhenetit shkojnë çdo ditë xhumaje. Aty fryn një erë nga Veriu, e cila bie mbi fytyrat dhe rrobat e tyre dhe atyre u shtohet bukuria. Ata kthehen te familjet e tyre pasi u është shtuar bukuria dhe familjarët u thonë: Pasha Allahun, juve ju është shtuar bukuria. Edhe ata u thonë: Pasha Allahun, edhe juve ju është shtuar bukuria**³⁶.

Sheikhu Islam Ibn Tejmija -Allahu e mëshiroftë- thotë: *«Tregu i xhenetit është pas vizitës së Allahut dhe shikimit të Tij siç ka qenë*

³⁴ E transmeton Ebu Ja'la dhe e saktëson sheikh Albani.

³⁵ E transmeton Derakutni dhe e saktëson sheikhu Islam Ibn Tejmije.

³⁶ E transmeton Muslimi.

adeti i tyre në dynja, sepse ata pas xhumasë shpërndareshin në tokë dhe kërkonin prej mirësive të Allahut»³⁷.

Ajo që sheikhu Islam Ibn Tejmija ka për qëllim në këtë citat, është ajeti i Kuranit, ku Allahu i madhëruar pas porosisë për namazin e xhumasë, thotë:

فَإِذَا قُضِيَتِ الصَّلَاةُ فَانْتَشِرُوا فِي الْأَرْضِ وَابْتَغُوا مِنْ فَضْلِ اللَّهِ

“Kur të kryeni namazin e xhumasë, përhapuni në tokë dhe kërkonte prej mirësive të Allahut!”³⁸.

Kështu ai, bazuar në këtë ajet, mendon se tregu i banorëve të xhenetit do të jetë pas takimit me Allahun, siç ishte adeti i tyre në dynja kur shpërndareshin pas namazit të xhumasë.

³⁷ Shih fjalët e autorit të libri “Mexhmu El-Fetaua”: 6/408.

³⁸ Suretu El-Xhumuah: 10.



Gjykimi i namazit të xhumasë

Vlerat e lartpërmendura të xhumasë dhe veçoritë e saj, bëjnë që ajo të kthehet në shenjë dalluese e pasuesve të mësimave të Allahut të madhëruar dhe të profetëve të Tij. Kështu, edhe gjykimi i këtij namazi do t'i përshtatet vlerave të xhumasë, sepse ajo shpreh identitetin e tyre. Ibn Kajimi -Allahu e mëshiroftë- thotë: “*Namazi i xhumasë është prej detyrave më të rëndësishme të islamit dhe prej grumbullimeve më të mëdha të myslimanëve, madje më i madhi grumbullim dhe më i kërkuari, me përjashtim të grumbullimit të ditës së Arafatit*”³⁹.

Këtë realitet e shohim te mënyra se si Allahu i madhëruar i thërret besimtarët për në xhuma. Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O ju që keni besuar, kur të thirret për në namaz ditën e xhuma, nxitoni për në përkujtimin e Allahut dhe lëreni tregtinë! Kjo është më e mirë për ju, sikur ju ta dinit”⁴⁰.

³⁹ Shih librin “Zad El-Mead”: 1/364.

⁴⁰ Suretu El-Xhumuah: 9

Fjala e Allahut [**O ju që keni besuar!**] është thirrje në emër të besimit dhe thirrja e Tij në këtë mënyrë u kujton besimtarëve besën mes tyre dhe Atij dhe që është fjala [**La ilahe il-la Allah, Muhamed resulullah**].

Fjala e Allahut [**nxitoni për në përkujtimin e Allahut**] d.m.th: shkoni për në xhuma me përkushtim ndaj saj. Hasen Basriu -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë ajet thotë: “*Nuk është për qëllim shpejtimi i këmbëve, por vajtja me zemra të përkushtuara, nijet dhe përujje, sepse ata (sahabët) ishin ndaluar të shkonin për në namaz veçse me qetësi dhe dinjitet*”⁴¹.

Fjala e Allahut [**dhe lëreni tregtinë!**] d.m.th: lëreni çdo preokupim tjetër veç vajtjes në xhuma! Ata’ bin Ebij Rabah, tabiini i njohur, i cili vdiq në vitin 114 sipas hixhretit -Allahu e mëshiroftë- në komentimin e këtij ajeti, thoshte: “*Kur të thirret ezani i xhumasë, të gjitha zanatet janë haram (d.m.th: jo vetëm tregtia)*”⁴². Komentuesit e Kuranit mendojnë se tregtia është marrë si shembull, sepse ajo ka qenë puna e tyre kryesore dhe se këtë gjykim e ka çdo punë tjetër, veç vajtjes në xhuma.

Pastaj Allahu i madhëruar e përfundon ajetin me nxitje për zbatimin e kësaj porosie [**Kjo është më e mirë për ju, sikur ju ta dinit**] d.m.th: lënia e çdo pune tjetër dhe drejtimi për të përkujtimi i Allahut në këto momente, është më i mirë për ju në dynja dhe në ahiret nëse ia dini atij vlerën.

⁴¹ Shih tefsir Ibn Ebij Hatim: 10/3356.

⁴² Shih librin Sahih El-Buhari.

Kategoritë e njerëzve që nuk e kanë detyrë vajtjen në xhuma

Vështirësitë dhe pamundësia e besimtarit për të kryer detyrat janë marrë në konsideratë në fenë e Allahut në të gjitha obligimet e saj. Kështu edhe në lidhje me xhumanë janë përjashtuar nga detyra e prezantimit në të disa kategori njerëzish, të cilët vajtjen në xhuma e kanë: ose të vështirë, ose të pamundur.

Tarik bin Shihab -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi salam- ka thënë: **“Xhumaja është hak i detyrueshëm për çdo mysliman (që të falet) me xhemat, me përjashtim të katër lloje njerëzish: rob i që është nën pronësinë e tjetrit (d.m.th: skllav që e ka humbur lirinë), femra, i vogli dhe i sëmuri”**⁴³.

Këtyre kategorive u shtohet edhe mysafiri në udhëtim, siç thotë sheikhu islam Ibn Tejmija Allahu e mëshiroftë: *“Nuk është ligjësuar xhumaja në udhëtim, sepse profeti -alejhi salam- ka bërë shumë udhëtime; tre herë umre, një herë haxh dhe ka marrë pjesë në më shumë se 20 beteja dhe asnjëherë nuk është transmetuar të ketë falur xhuma, madje në haxhin e tij në ditën e Arafatit e cila ishte edhe ditë e xhuma, ai pas hytbes ka falur namazet dy e nga dy pa zë, që do të thotë se ato nuk kanë qenë namaz xhumaje”*⁴⁴.

Këto kategori njerëzish, edhe pse nuk janë të detyruar të marrin pjesë në xhuma, kjo nuk do të thotë që ata të mos shkojnë për xhuma, nëse kanë mundësi, sidomos femrat, sepse xhumaja është mundësi e mirë për to për të mësuar dhe për t'u këshilluar.

⁴³ E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

⁴⁴ Shih fjalët e autorit në librin Mexhmu El-Fetaua: 178/24.

Ummu Hisham, e bija e El-Harith bin En-Numan -radiallahu anhuma- thoshte:

“Nuk e kam mësuar suren Kaf veçse prej gojës së profetit -alejhi selam- kur e lexonte atë çdo të xhuma mbi minber gjatë hytbes”⁴⁵.

A janë kushtet e vështira të motit justifikim për lënien e xhumasë?

Ibn Rexhebi -Allahu e mëshiroftë- thotë: *“Shumica e dijetarëve janë të mendimit se shiu dhe balta janë arsye për mosprezantim në xhuma dhe në namaze me xhemat, natën apo ditën qofshin ato”⁴⁶.*

Kjo që thotë ky dijetar është praktika e hershme e brezit të parë dhe ja disa transmetime në lidhje me xhumanë!

Ibn Abasi -radiallahu anhu- e ka porositur një herë muezinin e xhumasë në një ditë shiu që kur të thotë: hajje ales-salah (hajdeni në namaz!) të thotë: Es-Salatu fij Er-Rihal (d.m.th: faluni në banesat tuaja!). Njerëzit filluan të shihnin njëri-tjetrin nga habia dhe ai u tha: këtë gjë e kanë bërë edhe ata që janë më të mirë se unë.⁴⁷

Muhamed bin Sirini, tabiin i njohur -Allahu e mëshiroftë- thoshte: *“Nuk kundërshtonte njeri (prej brezit të hershëm) që, kur ditën e xhuma ka shi, i lejohet burrit të qëndrojë në shtëpi dhe të mos vijë në xhuma”⁴⁸.*

⁴⁵ E transmeton Muslimi.

⁴⁶ Shih librin Fet’h El-Barij të Ibn Rexhepit: 6/84.

⁴⁷ E transmeton Buhariu, Muslimi etj

⁴⁸ Shih librin Fet’h El-Barij të Ibn Rexhepit: 6/85.

Pra, përveç këtyre kategorive, të tjerët e kanë obligim të shkojnë për xhuma. Allahu i madhëruar për ta lehtësuar kryerjen e kësaj detyre, nuk ka bërë kusht tjetër për kryerjen e saj veç mbledhjes së njerëzve (d.m.th: xhematin).

Ky gjykim është gjykimi i sahabëve dhe i tabiinëve dhe ja disa shembuj!

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon: i kemi shkruar një herë Omerit -radiallahu anhu- për ta pyetur rreth xhumasë dhe ai na u përgjigj: “*Bëni xhuma kudo që të jeni!*”⁴⁹.

Ibn Mundhiri (dijetari i madh dhe i njohur i fikhut dhe i khilafit, i cili vdiq në vitin 319 Sipas hixhretit) thotë: “*Na është transmetuar nga Ibn Omeri -radiallahu anhu- se ai i shihte banorët pranë burimeve mes Mekës dhe Medinës duke falur xhumanë dhe nuk u thoshte gjë atyre (d.m.th: e miratonte veprimin e tyre). Dhe është transmetuar nga Umer bin Abdulazizi -Allahu e mëshiroftë- (prijësi i drejtë i myslimanëve, i cili vdiq në vitin 101 Sipas hixhretit) se i porosiste banorët pranë burimeve për këtë gjë (d.m.th: faljen e xhumasë)*”⁵⁰.

Kështu, bazuar në gjykimet e këtyre selefëve dhe në ajetin e lartpërmendur të xhumasë, ku Allahu i madhëruar porositi besimtarët që t’i përgjigjen ezanit të xhumasë, themi se njerëzit në një vend ku ka xhami -siç ndodh në qendrat e mëdha të banimit- duhet t’i përgjigjen atij ezani që dëgjojnë dhe nëse nuk ka xhami -siç ngjan në rastet e zonave më pak të banuara-, atëherë ata prapë duhet të bashkohen për të falur xhumanë në ambiente të tjera dhe të mos e lënë faljen e festës së tyre dhe përkujtimin e Allahut të madhëruar në këtë ditë.

⁴⁹ E transmeton Ibn Ebij Shejbe dhe e saktëson sheikh Albani.

⁵⁰ Shih librin e autorit me titull “El-Ishraf”: 2/87.

Sa duhet të jetë numri minimal i njerëzve, për të mbajtur një xhuma?

Kjo pyetje bëhet shpesh nga ata njerëz që banojnë në zona pak të banuara, apo nga ata që banojnë në zona të populluara, por që myslimanët përbëjnë pakicë. Përgjigjja është se gjykimi për këtë çështje varet nga kuptimi i fjalës “**xhemat**”. Disa dijetarë mendojnë se *xhemat* quhen tre veta e lart, ndërsa disa të tjerë mendojnë se duhen më shumë, dhe më e pakta që është thënë në lidhje me këtë çështje është dy veta e lart.

Gjykimi më i saktë është se *xhemat* quhet edhe dy veta kur falen bashkë dhe ky është mendimi i imam Sheukanit -Allahu e mëshiroftë-⁵¹. Këtë mendim, para tij e ka hedhur dijetari i njohur Ibrahim Nek’haij (mësuesi i Hammad bin Ebij Sulejmanit, prej të cilit ka mësuar imami i njohur Ebu Hanife, Allahu i mëshiroftë të gjithë), i cili thoshte: “*Nëse është edhe një tjetër me imamin, atëherë ata të dy së bashku falin xhumanë, me hytbe dhe dy rekate namaz*”. Ky mendim është gjithashtu mendimi i disa dijetarëve të tjerë si Hasen bin Haj (dijetar i madh i Kufes dhe adhurues i përkushtuar, i cili vdiq në vitin 169 Sipas hixhretit), Ebu Sulejman (Daud Dhahirij dijetar i madh, i cili vdiq në vitin 270 Sipas hixhretit) dhe mendimi i zgjedhur nga Ibn Hazmi -Allahu e mëshiroftë- (dijetari i madh i Andaluzisë, i cili vdiq në vitin 456 Sipas hixhretit)⁵². Pra, xhumaja është detyrë për myslimanët, festë e begatë për ta, shenjë dalluese e besimit të tyre dhe faktor i rëndësishëm për ruajtjen e tij.

⁵¹ Shih librin e autorit me titull “Neil El-Eutar”: 3/275.

⁵² Shih librin e Ibn Hazmit -Allahu e mëshiroftë- me titull “El-Muhal-la”: 3/249.



Përgatitja për xhuma

E përmendëm se dita e xhuma ka vlera të mëdha, mirëpo që ato vlera të arrihen nga besimtari në formën e tyre më të plotë, kërkohet përgatitje e veçantë.

Praktika e profetit Muhamed -alejhi selam- në këtë ditë, në lidhje me këtë qëllim, është si vijon:

1- Përkushtimi ndaj namazit të sabahut të ditës së xhuma dhe leximi i disa pjesëve të veçanta të Kuranit gjatë tij.

Namazit të sabahut të ditës së xhuma i duhet kushtuar rëndësi të veçantë që të falet me xhemat, sepse në lidhje me të disa dijetarë saktësojnë nga Profeti -alejhi selam- fjalën e tij:

“Më i miri namaz te Allahu, është namazi i sabahut me xhemat ditën e xhuma”⁵³.

Imam San’anij -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë mirësi thotë: “*Kjo, sepse namazi i sabahut është namazi më i mirë i pesë*

⁵³ E transmeton Ebu Nuajmi, Bejhakui dhe e saktëson sheikh Albani.

*vakteve, dita e xhuma është më e mira ditë e javës dhe namazet me xhemat janë më të mirat namaze dhe kështu ky namaz bëhet më i mirë se çdo namaz tjetër detyrë*⁵⁴.

Ndërsa në lidhje me pjesët e veçanta kuranore që lexohen gjatë tij, Ibn Abasi -radiallahu anhu- tregon:

“Profeti -alejhi selam- në namazin e sabahut të ditës së xhuma, lexonte suren Es-Sexhde dhe suren El-Insan”⁵⁵.

Përzgjedhja e këtyre pjesëve kuranore nuk është e paqëllimtë nga ana e profetit -alejhi selam-, sepse përmbajtja e tyre u përshtatet veçorive të ditës së xhuma për të cilat ai na ka njoftuar. Ibn Hubejra (dijetar i madh i kohës së dinastisë Abasite, i cili vdiq në vitin 560 Sipas hixhretit -Allahu e mëshiroftë-) në komentimin e këtij hadithi, thotë: *“Leximi i sures Es-Sexhde dhe El-Insan, në namazin e sabahut të ditës së xhuma, i përshtatet veçorive të Ademit -alejhi selam-, të cilit iu përkulën melaiket e Allahut dhe krijimit të tij në ditën e xhuma”*⁵⁶.

Kështu, leximi i këtyre pjesëve kuranore për besimtarin, do të thotë kujtim i vlerave të xhumasë dhe për rrjedhojë do t'i kushtojë asaj interesin e duhur.

2- Leximi i sures El-Kebf gjatë ditës së xhuma apo natës së saj.

Ebu Said Khudrij -radiallahu anhu- në lidhje me këtë praktikë thotë se profeti -alejhi selam- ka thënë:

⁵⁴ Shih fjalët e autorit në librin e tij me titull “ET-Tenujir”: 2/567.

⁵⁵ E transmeton Muslimi.

⁵⁶ Shih fjalët e autorit në librin e tij me titull “El-Ifsah”: 3/236.

“Kush lexon sures El-Kehf ditën e xhuma, ajo do ta ndriçojë atë mes dy xhumave”⁵⁷.

Imam Shafiu -Allahu e mëshiroftë- thoshte: *“E dua leximin e sures El-Kehf natën e xhuma, apo ditën e saj, për shkak të atyre citateve profetike të përcjella në lidhje me të”⁵⁸.*

Edhe leximi i sures El-Kehf ditën e xhuma duhet të ketë ardhur për shkak të përmbajtjes së saj, sepse ajo si temë kryesore në përmbajtjen e saj ka qëndresën e rrallë të disa besimtarëve të hershëm në besimin e tyre, të cilët Allahu i madhëruar i bëri shembull të mirë për mbarë njerëzimin me përkrahjen dhe ndihmën e çuditshme që patën prej Tij. Ajo gjithashtu përshkruan edhe disa ngjarje, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me veçoritë e xhumasë si: historia e Adem-it -alejhi selam- me Iblisin, ora e fundit e dynjasë dhe disa shenja të afrimit të saj, kiameti dhe tmerret e tij, sepse këto ngjarje siç jemi njoftuar, ose kanë ndodhur ditën e xhuma, ose do të ndodhin në këtë ditë.

Pra, edhe leximi i kësaj sureje përbën një tjetër lidhje me veçoritë e ditës së xhuma dhe rëndësisë së saj.

3- Dërgimi salavate mbi profetin Muhamed -alejhi selam-

Eus bin Eus -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

⁵⁷ E transmeton Hakimi, Bejhakui dhe e saktëson sheikh Albani.

⁵⁸ Shih fjalët e autorit në librin e tij “El-Um”: 1/239.

“Prej ditëve tuaja më të mira është dita e xhuma: Në këtë ditë është krijuar Ademi. Në këtë ditë i është marrë shpirti (dmth: ka vdekur). Në këtë ditë është fryrja e surit dhe në këtë ditë është kllapia. Çoni në këtë ditë salavate mbi mua, sepse salavatet tuaja më paraqiten! E pyetën: O i dërguari i Allahut, si të paraqiten salavatet tona për ty, kur ti je tretur? Ai u tha: Allahu i madhëruar ia ka bërë haram tokës tretjen e trupave të profetëve”⁵⁹.

Hadithi, pasi përmend disa vlera të xhumasë, nxit për t’u lutur për profetin Muhamed -alejhi selam-, sepse salavatet janë lutje për të. Kjo do të thotë se, ka një lidhje të ngushtë mes ditës së xhuma dhe profetit Muhamed -alejhi selam-. Lidhja e tij me këtë ditë nuk mund të jetë tjetër përveç faktit se, ai është shkaku që ne sot njohim mirësitë e kësaj dite dhe ymeti i tij është i vetmi ymet që e ka vlerësuar këtë ditë ashtu siç e meriton ajo të vlerësohet.

El-Mula Ali El-Karij -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: *“Kjo ditë është më e mira e ditëve dhe duhet të shfrytëzohet në shërbim të më të mirit të krijesave”⁶⁰.*

Prej formave të salavateve, të cilat mund t’i thotë besimtari për profetin -alejhi selam- është edhe ajo që themi gjatë namazit, madje ajo është më e mira, sepse është sugjeruar nga vetë profeti -alejhi selam-:

Allahumma sal-li ala Muhammedin ue ala ali Muhammed, kama sal-lejte ala Ibrahimie ue ala ali Ibrahimie, inneke Hamijdun Mexhijd!

⁵⁹ E transmeton Ebu Daudi, Ibn Maxhe dhe e saktëson sheikh Albani.

⁶⁰ Shih librin e autorit me titull “Mirkat El-Mefatih”: 3/1016.

Allahumme barik ala Muhammedin ue ala ali Muhammed, kema barekte ala Ibrahimie ue ala ali Ibrahimie inneke Hamijdun Mexhijd!

4- Pastrimi dhe zbukurimi

Profeti -alejhi selam- në këtë ditë i kushtonte rëndësi të veçantë pastrimit, sidomos larjes së trupit, i cili njihet në terminologjinë islame si gusli i xhumasë. Ai nuk mjaftohej në këtë ditë vetëm me abdesin -siç bënte zakonisht me namazet e tjera- dhe porosiste: **“Kur të vijë ndonjëri prej jush në xhuma, të marrë gusl”**⁶¹, apo hadithi: **“Gusli i xhumasë është detyrë për çdo të rritur”**⁶².

S’ka dyshim se ky gusl është detyrë në qoftë se trupi mban erë nga djersa dhe puna, e nëse jo, atëherë ai mbetet i pëlqyeshëm dhe synet i fortë, i cili prapë nuk është mirë të neglizhohet.

Sheikhul Islam Ibn Tejmija thotë: *«Hadithet në lidhje me guslin ditën e xhuma janë te shumta -dhe ai është detyrë për atë që ka djersë dhe mban erë-. Ai kërkohet për shkak të bashkimit të njerëzve në xhami dhe prezantimit të melaikeve bashkë me njerëzit, sepse profeti -alejhi selam- thotë: “Melaiket i mundon (i bezdis) ajo që i mundon bijtë e Ademit”*⁶³,⁶⁴.

Profeti -alejhi selam- gjithashtu porosiste: **“Tre gjëra i ka hak**

⁶¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁶² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁶³ E transmeton Muslimi

⁶⁴ Shih fjalët e autorit të librat “Mexhmu El-Fetaua”: 21/308 dhe “El-Fetaua El-Kubra”: 5/307.

çdo mysliman: guslin ditën e xhuma, misvakun për pastrimin e gojës dhe parfumin nëse ka⁶⁵.

Ndërsa në një hadith tjetër, ai ka shtuar edhe veshjen e rrobave më të mira që ka besimtari dhe thoshte: **“Kush lahet ditën e xhuma, pastrohet mirë, vesh rrobat më të mira që ka dhe parfumset me parfumin që gjen në shtëpi, pastaj vjen në xhuma dhe nuk shkujdeset dhe as ndan mes dy vetave, i falen atij gjynahet mes asaj xhumaje dhe tjetrës**⁶⁶.

Të gjitha këto veprime kanë ardhur për shkak se kjo ditë është festa e myslimanëve dhe zbukurimi në këtë ditë duhet të jetë si për festë.

5- Vajtja në xhami para se imami të ngjitet në minber.

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Ditën e xhuma, në çdo derë prej dyerve të xhamisë ka melaïke që shkruajnë emrat e njerëzve sipas radhës që vijnë. Kur imami ngjitet në minber, ata i mbyllin regjistrat dhe vijnë për të dëgjuar përkujtimin e Allahut. Ai që vjen në orën e parë është si ai që bën kurban një deve. Ai që vjen në orën e dytë është si ai që bën kurban një lopë. Ai që vjen në orën e tretë është si ai që bën kurban një dash. Ai që vjen në orën e katërt

⁶⁵ E transmeton Ahmedi dhe e saktëson sheikh Albani.

⁶⁶ E transmeton Ibn Maxhe dhe e saktëson sheikh Albani.

është si ai që bën kurban një pulë dhe ai që vjen në orën e pestë është si ai që jep sadaka një vezë⁶⁷.

Hadithi nxit për vajtjen herët në xhami, para se imami të ngjitet në minber dhe e ndan kohën para xhumasë në pesë orë, sa më herët të jetë aq më shumë shpërblim ka. Kjo, sepse dita e xhuma është ditë feste e veçuar për ibadet dhe prandaj duhet shpejtuar për në xhami që të përfitohet prej bereqetit të saj.

Ebu Talib El-Mekkij, prej njerëzve të devotshëm dhe të hershëm të këtij ymeti -Allahu e mëshiroftë-, thoshte: “*I pari bidat i shfaqur në Islam është lënia e vajtjes herët në xhami (ditën e xhuma)*”⁶⁸. Kjo do të thotë se të parët e këtij ymeti e patën kthyer në traditë vajtjen herët për xhuma, gjë të cilën e kanë neglizhuar të mëvonshmit.

Kështu, përderisa hadithi njofton për pesë orë të begata para xhumasë, lind pyetja se kur fillon ora e parë e saj?

Imam Gazaliu -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje, thotë: “*Në kohën e brezit të parë, në errësirën pas agimit (dmth: pas agimit të ditës së xhuma), rrugët ishin të mbushura plot me njerëz duke ecur me kandila në duar për në xhami, si në ditët e festave. Ky adet më vonë u harrua derisa thuhet se bidati i parë i shfaqur në Islam është lënia e vajtjes herët në xhami. Si nuk kanë turp myslimanët prej hebrenjve dhe të krishterëve, të cilët shkojnë herët në sinagogat dhe kishat e tyre ditën e shtunë dhe të diel, apo prej kërkuesve të dynjasë, të cilët shkojnë herët nëpër tregje për të shitur, blerë dhe për fitim. Pse të mos i konkurrojnë ata kërkuesit e ahiretit kur thuhet se afërsia e*

⁶⁷ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁶⁸ Shih librin e autorit “Kut El-Kulub”: 1/127.

*njerëzve kur të shikojnë te fytyra e Zotit do të jetë sipas kohës së vajtjes së tyre për në xhuma!*⁶⁹.

Pra, interesimi i selefëve ditën e xhuma fillonte që me kohën pas agimit dhe që nga ky moment fillon numërimi i orëve të begata.

6- Shfrytëzimi i vajtjes herët në xhami për namaz nafile dhe ibadet

Namazi nafile ka qenë ibadeti kryesor me të cilin merreshin sahabët pas hyrjes në xhami. Ky ibadet është përmendur në disa hadithe, prej tyre:

Ebu Hurejra radiallahu anhu tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **“Kush merr gusl ditën e xhuma, pastaj vjen në xhuma dhe fal aq sa i ka caktuar Allahu, pastaj hesht derisa imami të mbarojë hytben dhe pastaj falet me të, i falen gjynahet mes asaj xhumaje dhe xhumasë tjetër (dmth: xhumasë së kaluar) dhe tre ditë më shumë”**⁷⁰.

Fjala e tij [**pastaj vjen në xhuma dhe fal aq sa i ka caktuar Allahu**] tregon për ligjshmërinë e angazhimit të besimtarëve me namaz nafile nga hyrja e tyre në xhami deri në ngjitjen e imamit në minber. Sheikhul Islam Ibn Tejmija -Allahu e mëshiroftë- citon: *“Sahabët kur vinin në xhami ditën e xhuma, faleshin aq sa mundeshin, që nga momenti kur ata hynin në xhami. Prej tyre kishte që falnin dhjetë rekate, prej tyre kishte që falnin dymbëdhjetë rekate,*

⁶⁹ Shih fjalët e autorit në librin e tij Ihja Ulum Ed-Dijn: 1/182.

⁷⁰ E transmeton Muslimi.

*prej tyre kishte që falnin tetë rekate dhe prej tyre kishte që falnin më pak se kaq*⁷¹.

Angazhimi me namaz nafile kërkon që besimtari të dijë Kuran përmendësh, e nëse dikush prej tyre nuk di, atëherë, ai merret me ibadete të tjera si leximi i Kuranit, salavate, dhikr etj, sepse dita e xhuma është ditë ibadeti dhe përkujtimi për Allahun e madhëruar.

Këto janë disa adete të profetit Muhamed -alejhi selam-, të cilat ndihmojnë në arritjen e begatisë së kësaj dite, apo e përgatisin besimtarin për to dhe veç tyre nuk është përmendur gjë tjetër në lidhje me këtë çështje, as namaz, as agjërim dhe as sadaka. Madje ai porosiste: **“Mos e veçoni natën e xhuma me ndonjë namaz (që nuk e keni zakon) dhe as mos e veçoni ditën e saj me ndonjë agjërim**⁷².

Kjo ndoshta -dhe Allahu e di më së miri- se një namaz tjetër i veçantë veç xhumasë ia ul vlerën namazit të xhumasë, ndërsa agjërimi i ditës së xhuma ia prish asaj nocionin të qëniti festë.

Imam Tibij -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: *“Shkakun e ndalimit është se Allahu i madhëruar e ka veçuar ditën e xhuma me një ibadet dhe nuk ka dashur që njeriu ta veçojë atë me diçka tjetër veç saj*⁷³.

⁷¹ Shih fjalët e autorit në librin “Mexhmu El-Fetaua”: 24/189.

⁷² E transmeton Muslimi.

⁷³ Shih fjalët e autorit te libri i tij sherh El-Mishkat: 5/1610



Ezani i xhumasë

Xhumaja ka ezan për lajmërimin e fillimit të saj dhe ai është përmendur në Kuran në suren El-Xhumuah, e cila mban emrin e saj. Allahu i madhëruar në këtë sure thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O ju që keni besuar! Kur të thirret për në namaz ditën e xhuma (d.m.th: kur të thirret ezani i saj), nxitoni për në përkujtimin e Allahut dhe lëreni tregtinë! Kjo është më e mirë për ju, sikur ta dinit”⁷⁴.

Pra, xhumaja fillon me ezan dhe ezani i përmendur në ajet është ai kur imami ulet në minber, sepse në kohën e profetit -alejhi selam- nuk thirrej ezan tjetër veç tij.

Në lidhje me këtë çështje, sahabiu i nderuar Saib bin Jezijd -radiallahu anhu-thotë: **“Ezani, ditën e xhuma ka qenë në fillim të saj, atëherë kur imami ulej në minber. Kështu ka qenë në kohën e profetit -alejhi selam-, Ebu Bekrit dhe Omerit -radiallahu anhu- u shtuan njerëzit dhe ai shtoi ezanin e tretë në Ez-Zeura (vend në tregun e Medines)”⁷⁵.**

⁷⁴ Suretu El-Xhumuah: 9.

⁷⁵ E transmeton Buhariu.

Sahabiu e quan ezanin e shtuar nga Uthmani -radiallahu anhu- [**ezani i tretë**], sepse xhumaja ka: ezanin kur imami ulet në minber, ikametin pas hytbes dhe ky që shtoi Uthmani ishte i treti.

Imam Ibn Rexhepi -Allahu e mëshiroftë-, në lidhje me renditjen e këtyre ezaneve thotë: “*Kur Uthmani -radiallahu anhu- shtoi ezanin e tretë, ky i treti u bë i pari dhe ai që thirret para imamit (d.m.th: kur imami ulet në minber) u bë i dyti*”⁷⁶.

Bazuar në përshkrimet e përmendura në ajete dhe në hadith përfitohet:

1- Ezani i Uthmanit -radiallahu anhu- është ezan lajmërimi për afrimin e kohës së xhumasë dhe ai në kohën e tij thirret para se imami të hynte në xhami, me qëllim që njerëzit të mblidheshin para se ai të fillonte hytben.

Kështu, ky ezan nuk ka lidhje me fillimin e xhumasë, madje ai në atë kohë, as nuk thirret në xhami, por në treg siç citon hadithi.

2- Ezani, i cili thirret kur imami ulet në minber është ezani i fillimit të xhumasë dhe është ezani i kohës së profetit -alejhi salam-. Ai në atë kohë ka qenë me zë të dëgjueshëm jashtë xhamisë, sepse ajeti i cili tregon për të, thotë: [**Kur të thirret për në namaz ditën e xhuma** (d.m.th: të thirret ezani i saj), **nxitoni për në përkujtimin e Allahut**]. Pra, përderisa Allahu i madhëruar u kërkon njerëzve që dëgjojnë ezanin e xhumasë, të nxitojnë për në përkujtimin e Allahut, do të thotë se ai ezan ishte i dëgjueshëm jashtë xhamie.

3- Në atë kohë nuk ka pasur vaz para xhumasë (d.m.th: këshilla

⁷⁶ Shih librin e autorit me titull sherh fet’h El-Barij: 8/69.

të tjera të cilat i jep imami në kohët e sotme para xhumasë), sepse imami në atë kohë nuk dilte para njerëzve veçse për hytbe. Kur ai ulej në minber, menjëherë pas uljes së tij thirrej ezani i xhumasë dhe fillonte hytbia.

Fjala e Allahut ku përmendet ezani i xhumasë dhe pastaj thuhet [**nxitoni për në përkujtimin e Allahut**] d.m.th: *nxitoni për te hytbia* siç shpjegon komentuesi i njohur i Kuranit Muxhahidi -Allahu e mëshiroftë-⁷⁷.

Imam Ibn Kajimi -Allahu e mëshiroftë- thotë: “*Profeti -alejhi selam- vonohej ditën e xhuma derisa mblihdeshin njerëzit. Kur ata mblihdeshin, ai dilte. Kur hynte në xhami, u jepte atyre selam dhe* .⁷⁸“*kur ngjitej në minber kthehej me fytyrë nga ata*

Më vonë, në kohën e sundimit të Hisham bin Abdulmelikut (prijës i myslimanëve i kohës së dinastisë Emevite, i cili vdiq në 125 sipas hixhretit -Allahu e mëshiroftë-), ai e zhvendosi në xhami këtë ezan që shtoi Utmani -radiallahu anhu- dhe e la atë të dëgjueshëm për jashtë. Ndërsa atë që thirrej pranë xhamisë kur imami ulej në minber, e futi brenda saj duke e bërë kështu atë të padëgjueshëm për ata që janë jashtë.

Ja çfarë thotë dijetari i njohur andaluzian Ibn Rushdi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me veprimin e Hishamit -Allahu e mëshiroftë!

“*Në kohën e sundimit të Hishamit, ai e kaloi ezanin e Ez-Zeurasë në Meshrafë (vend të ngritur pranë xhamisë, sepse xhamitë në atë*

⁷⁷ Shih tefsir Et-Taberij: 23/282.

⁷⁸ Shih librin e autorit me titull “Zad El-Mead”: 1/414.

*kohë nuk kanë pasur minare) dhe atë që thirrej në mesbrafe e kaloi brenda xhamisë përpara tij*⁷⁹.

Këtë veprim të Hishamit -Allahu e mëshiroftë- ndryshe nga veprimi i Uthmanit -radiallahu anhu- nuk e kanë pëlqyer shumë dijetarë dhe e konsideronin atë si bidat, sidomos dijetarët e Medines me në krye imam Malikun -Allahu e mëshiroftë-. Ai thoshte: “*Ezani brenda xhamisë para imamit nuk është prej traditës së hershme (profetike)*”⁸⁰.

Imam Maliku me këtë fjalë nënkupton -dhe Allahu e di më së miri- se ezani i cili thirret kur imami është ulur në minber, duhet të thirret në minare, që të jetë i dëgjueshëm për njerëzit siç ka qenë në kohën e Profetit -alejhi selam- dhe jo brenda xhamisë siç veproi Hishami, sepse ky është momenti i fillimit të xhumasë dhe këtu fillojnë angazhimet e saj.

Veprimi i Hishamit edhe pse u kritikua nga dijetarët, u ndoq më pas nga njerëzit. Ai më vonë u bë shkak edhe për bidate të tjera, sepse njerëzit filluan të mendojnë se ezani i parë është ezani i fillimit të xhumasë. Pastaj ai u bë shkak edhe që ata të mendojnë se pas ezanit të parë ka namaz sunet të veçantë për xhumanë, siç ka për namazet e tjera të ditës, ndërkohë që në kohën e profetit -alejhi selam- nuk ka patur veçse një ezan. Kur ai ezan thirrej, profeti -alejhi selam- ishte ulur në minber dhe pas tij ai menjëherë fillonte hytben dhe kështu njerëzit preokupoheshin me dëgjimin e hytbes dhe jo me namaz.

⁷⁹ Shih librin “El-Itisam” te imam Shatibiut: 1/492.

⁸⁰ Shih librin “El-Kafij” të dijetarit të njohur malikij Ibën Abdul-Berr: 1/251

Ligjshmëria e ezanit të Uthmanit -radiallahu anhu-

Kur Uthmani -radiallahu anhu- e shtoi këtë ezan, sahabët e pranishëm në atë kohë në përgjithësi nuk e kanë kundërshtuar atë, çka do të thotë se ky ezan ishte i nevojshëm dhe gjithashtu nuk binte ndesh me mësimet profetike.

Es-Saib bin Jezid (sahabiu i lartpërmendur)-radiallahu anhu- në një transmetim tjetër në lidhje me këtë ngjarje, thotë: *“(Uthmani) kur u zgjerua Medina dhe u shtuan njerëzit, shtoi ezanin e parë. Njerëzit nuk e kritikuan atë për këtë veprim, siç e kritikuan për plotësimin e namazit në Mina”*⁸¹.

Imam Is’hak bin Rahauëjh -Allahu e mëshiroftë- (dijetar i madh i hadithit dhe i fikhut, i cili vdiq në vitin 238 sipas Hixhretit) në lidhje me ezanin e tij thotë: *“Ezani i parë i xhumasë është i shtuar (d.m.th: jo veprim profetik), e ka shtuar Uthmani -radiallahu anhu-. Ai mendoi se nuk do dëgjohej veçse nëse shtohet numri i muezinëve që të lajmërohen të largët dhe pastaj u kthye në adet, sepse prijësit e kanë detyrë t’i vëzhgojnë këto çështje te njerëzit”*⁸².

Imam Shatibiu -Allahu e mëshiroftë- gjithashtu në lidhje me veprimin e tij thotë: *“Ezani në Ez-Zeura u vu atje siç është në origjinë për lajmërim. Ai e vuri atje, sepse nuk do të ishte dëgjuar, nëse do të ishte vënë në xhami siç ishte në kohën para tij. Kështu, ky ezan u bë diçka krejt tjetër që nuk kishte qenë më përpara. Ai bëri ixhtihad si në çdo çështje ixhtihadi dhe përderisa qëllimi i ezanit është lajmërimi, atëherë ai mbeti në origjinën e tij dhe vënia e tij në atë vend nuk bie ndesh me këtë qëllim ndërkohë që nuk kishin lindur*

⁸¹ E transmeton Ibn Humejd, Ibn El-Mundhir, Ibn Merdeuejh. Shih citatin e tij në librin “Ed-Durr El-Menthur” të imam Sjutit: 8/158.

⁸² Shih fjalët e autorit te libri Fer’h El-Barij i Ibn Rexheb El-Hanbelij: 8/220.

në lidhje me të mendime (sugjerime) të reja...”⁸³.

Në këto citate që u përmendën këtu dhe në ato të tjerat që u përmendën pak më lart, shpalosen disa arsye që i japin legjitimitet veprimt të Uthmanit -radiallahu anhu-:

1- Nevoja për t’i lajmëruar njerëzit pas zgjerimit të Medines.

2- Mosreagimi i njerëzve në kohën e tij tregon miratim nga ana e tyre⁸⁴.

⁸³ Shih librin e autorit me titull El-Itisam: 1/493.

⁸⁴ Me fjalën [mosreagim] kam për qëllim atë që thashë pak më lart [në përgjithësi], sepse në librat që mbledhin fjalët dhe mendimet e sahabëve gjendet një reagim i Ibn Omerit -radiallahu anhu-.

Imam Taberani në librin e tij “Musned Esh-Shamijijn” përcjell edhe këtë lajm. Ibn Omeri -radiallahu anhu- thoshte: **“Profeti -alejhi selam- kur ulej në minber, Bilali thirrte ezanin dhe kur profeti alejhi selam mbaronte hytben e tij, ai thërriste ikametin. Ezani i parë është bidat”**.

Nuk dihet mirë se çfarë ka pasur për qëllim Ibn Omeri -radiallahu anhu- me fjalën bidat: ka pasur për qëllim ta kritikojë veprimin e Uthmanit, apo ka pasur për qëllim thjesht të njoftojë se ky veprim është diçka e re e që nuk ka qenë në kohën e Profetit -alejhi selam-. Kjo sepse fjala bidat përdoret për të dyja qëllimet, siç thekson Ibn Haxheri -Allahu e mëshiroftë-.

Ibn Rexhep El-Hanbelij, në librat e tij përcjell edhe diçka tjetër shtesë në lidhje me thënien e Ibn Omerit. Ai përcjell se Ibn Omeri -radiallahu anhu-ka thënë: *“Ai (ezani i parë i xhumasë) është bidat dhe çdo bidat është humbje edhe nëse njerëzit e shohin si të mirë”*. Kështu, sipas këtij transmetimi, nëse merret si i saktë, duket qartë se ai ka pasur për qëllim ta kritikojë atë dhe Allahu e di më së miri.

Në lidhje me reagimin e Ibn Omerit -radiallahu anhu- nuk mund të lëmë pa përmendur edhe një realitet tjetër të nevojshëm për të kuptuar reagimin e tij se, nëse ai ka pasur për qëllim të kritikojë veprimin e Uthmanit -radiallahu anhu-, nuk dihet mirë se cilës kohë i referohet: kohës së Uthmanit -radiallahu anhu-, apo kohës pas tij, sepse Ibn Omeri -radiallahu anhu- ka jetuar pas Uthmanit gati 40 vjet; Uthmani -radiallahu anhu- ka vdekur në vitin 35 pas hixhretit, ndërsa Ibn Omeri ka vdekur në vitin 73 apo 74 pas hixhretit.

3- Prijësit kanë të drejtë të vëzhgojnë çështjet fetare të njerëzve dhe të ndërhyjnë në to, në mënyrë që ato të kryhen në kohën e duhur dhe mënyrën më të mirë të mundshme, siç kanë të drejtë të vëzhgojnë dhe të ndërhyjnë në çështjet e dynjasë së tyre.

4- Ezani i tij ishte thjesht lajmërim për afrimin e kohës së xhumasë dhe pa ndikim në ritet e saj, sepse ishte jashtë tyre dhe si i tillë nuk zuri vendin e ndonjë syneti profetik.

5- Xhumaja në atë kohë, pas shtimit të këtij ezani, mbeti ajo që ishte në kohën e profetit -alejhi selam-, fillonte me ezanin tjetër (ezanin profetik) dhe mbaronte me namazin e xhumasë.

A është sot i nevojshëm ezani i Uthmanit -radiallahu anhu-?

Duhet ditur se veprimet e shtuara mbi bazën e nevojës për të arritur qëllimin e shariatit në lidhje me një ibadet të caktuar, varen nga prezenca e asaj nevoje, që do të thotë se, ato veprime në një kohë tjetër në rrethana të tjera mund të mos kryhen, sepse nuk ka nevojë për to. Le të kthehemi edhe njëherë te citati i lartpërmendur i dijetarit Is'hak bin Rahauelj -Allahu e mëshiroftë- i cili thotë: *“Ezani i parë i xhumasë është i shtuar (d.m.th: jo veprim profetik), e ka shtuar Uthmani -radiallahu anhu-. Ai mendoj se nuk do dëgjohej veçse nëse shtohet numri i muezinëve që të lajmërohen të largët dhe pastaj u kthye në adet, sepse prijësit e kanë detyrë t'i vëzhgojnë këto çështje te njerëzit”*⁸⁵.

Ibn Rexhepi -Allahu e mëshiroftë- e komenton këtë thënie dhe thotë: *“Kjo nënkupton se ky veprim varet nga mendimi i prijësit.*

⁸⁵ Shih fjalët e autorit të libri Fe'h El-Barij i Ibn Rexheb El-Hanbelij: 8/220.

*Nëse ai e sheh të nevojshme për shkak të numrit të madh të njerëzve e vepron, përndryshe jo, nëse nuk ka nevojë për të*⁸⁶.

Kjo që thotë ky dijetar është të ecësh me qëllimin e Uthmanit -radiallahu anhu-, sepse ai pikërisht këtë ka dashur: të zgjidhë një problem të kohës së tij dhe nuk ka dashur ta shndërrtojë veprimin e tij në një adet të padiskutueshëm dhe të përhershëm, siç janë adetet profetike.

Ezani i Uthmanit -radiallahu anhu- përveç këtij këndvështrimi duhet parë edhe në një këndvështrim tjetër, sepse ky ezan tashmë nuk është më jashtë riteve të xhumasë siç ka qenë në kohën e Uthmanit -radiallahu anhu-, por është brenda tyre dhe njerëzit kanë shtuar në lidhje me të adete të tjera të paqena në kohën e tij. Kur një veprim fillon të ndikojë në këtë lloj mënyre, gjykimi i tij ndryshon. Ja si shprehet dijetari Ibn El-Arabij El-Malikij -Allahu e mëshiroftë- (dijetar i njohur malikij, i cili vdiq në vitin 543 sipas hixhretit) kur shihte ndryshimet që i kanë ndodhur xhumasë për shkak të këtij ezani! Ai thotë: *“Njerëzit më vonë e menduan këtë ezan si pjesë bazë të xhumasë dhe caktuan tre muezinë dhe ky ishte një perceptim i gabuar. Pastaj ata i bashkuan muezinët në një kohë dhe u bë gabim mbi gabim. I kam parë ata (muezinët) në qytetin e Paqes (dmth: Bagdatin) duke thirrur ezan së bashku pas ezanit të minares para imanit siç bënin edhe te ne në kohën e disa sundimtarëve të shkuar dhe të gjitha janë bidat*⁸⁷.

Bazuar në dy këndvështrimet e lartpërmendura, janë të shumtë zërat, si në kohën tonë ashtu edhe në kohë më të hershme se,

⁸⁶ Shih fjalët e autorit të libri Fet’h El-Barij: 8/221.

⁸⁷ Shih librin e autorit me titull Ahkam El-Kuran: 4/247.

ky ezan është më mirë të lihet dhe ditën e xhuma të mjaftohet vetëm me ezanin profetik. Ka edhe zëra të tjerë që thonë se ky veprim duhet të ndiqet, sepse është veprim i një prijësi të drejtë dhe profeti -alejhi selam- në përgjithësi ka porositur që praktika e tyre të ndiqet. Megjithatë, lënia e këtij ezani, apo veprimi i tij është në dorën e atyre që drejtojnë çështjet fetare të myslimanëve dhe përsa kohë ata porosisin të veprohet duhet të veprohet, sepse drejtuesve duhet t'u bindemi edhe kur mendojmë se perceptimi i tyre është i gabuar, siç kanë bërë sahabët me një veprim tjetër të Uthmanit -radiallahu anhu-: plotësimi i namazit në Mina.

Ç'duhet të bëjë besimtari kur thirret ezani i parë i lajmërimit?

Duke qenë se ky ezan në kohët e sotme i është bashkangjitur xhumasë dhe e drejta për të vendosur në lidhje me të është e drejtuesve, atëherë do ishte me shumë rëndësi për lexuesin t'i jepej përgjigje kësaj pyetjeje. Prandaj në përgjigje të saj themi se, në momentin kur thirret ezani i parë i lajmërimit, apo ndryshe ezani i Uthmanit -radiallahu anhu-, ata që janë jashtë xhamie duhet të nxitojnë për në xhami, sepse pikërisht për lajmërimin e tyre është thirrur. Ndërsa ata që në atë moment janë në xhami, vazhdojnë adetin e tyre derisa të hyjë imami dhe të thirret ezani tjetër.

Kështu, për ata që janë në xhami, ai që është duke u falur -siç bënin sahabët-, vazhdon namazin, ai që është duke lexuar Kuran, vazhdon leximin dhe ai që është duke bërë tespah, apo duke dërguar salavate mbi profetin -alejhi selam- madje kjo është më e mirë se tespah, sepse profeti -alejhi selam- ka porositur për to, vazhdon në veprimin e tij.



Koha e namazit të xhumasë

Shkaku i namazit të xhumasë është ardhja e kësaj dite që do të thotë se prezenca e këtij fenomeni natyror bën detyrë namazin e xhumasë.

Ibn Rexheb El-Hanbelij (dijetari i njohur i fushës së hadithit dhe i fik'hut, i cili vdiq në vitin 795 Sipas hixhretit) thoshte:

“Shkaku i xhumasë është dita e saj dhe prandaj ajo cilësohet me të dhe thuhet: namazi i xhumasë”⁸⁸.

Pra, namazi i xhumasë ka lidhje me këtë ditë dhe jo me pozicionin e diellit siç kanë namazet e tjera.

Kështu, duke qenë se dita e xhuma ka një interval të gjatë kohor, i cili sipas librit të Allahut fillon nga agimi deri në perëndim të diellit, atëherë lind pyetja se në cilën pjesë të këtij intervali kohor bën të falet xhumaja?

Dy pjesë të këtij intervali kohor: pjesa para lindjes së diellit dhe pjesa e ikindisë janë përjashtuar nga kjo mundësi, sepse profeti -alejhi selam- në këto pjesë kohore preokupohej me namazin e

⁸⁸ Shih librin e autorit me titull Fer'h El-Barij: 8/178.

sabahut dhe namazin e ikindisë dhe kështu nuk mbetet tjetër veçse .pjesa e paradites dhe koha e namazit të drekës

Duke parë hadithet e profetit -alejhi selam- gjejmë se ai këtë namaz e ka falur edhe në kohën e drekës edhe para saj, çfarë do të thotë se, edhe koha e paradites edhe koha e namazit të drekës janë kohë për faljen e namazit të xhumasë.

Ja çfarë është përcjellur nga profeti -alejhi selam- në lidhje me faljen e xhumasë!

Xhabir bin Abdullahi -radiallahu anhu- thotë: **“Profeti -alejhi selam- falte xhumanë dhe ne pastaj shkonim te devetë tona, të cilat përdorëshin për të nxjerrë ujë nga pusi për vaditje dhe i lironim ato nga puna kur dielli kalonte zenitin”**⁸⁹.

Fjala e tij [**dhe i lironim ato nga puna kur dielli kalonte zenitin**] d.m.th: përderisa ata këtë punë e bënin pas xhumaje dhe dielli në atë moment kalonte zenitin, atëherë falja e xhumasë ka qenë para kohës së namazit të drekës, sepse namazi i drekës nuk hyn veçse pasi dielli kalon zenitin.

Enesi -radiallahu anhu- tregon: **“Profeti -alejhi selam- e falte xhumanë, kur dielli kalonte zenitin”**⁹⁰.

Fjala e tij [**e falte xhumanë, kur dielli kalonte zenitin**] d.m.th: Profeti -alejhi selam- namazin e xhumasë e ka falur në kohën e namazit të drekës, ndërsa ezani dhe hytja i bie të kenë qenë para kohës së namazit të drekës.

⁸⁹ E transmeton imam Ahmedi, Muslimi dhe Nesaiu.

⁹⁰ E transmeton Buhariu.

Prandaj imam Ahmedi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me kohën e xhumasë thoshte:

“Koha e xhumasë është edhe para zenitit edhe pas zenitit, cilën prej tyre të zgjedhë lejohet”⁹¹.

Lejimi i faljes së xhumasë gjatë paradites vjen edhe për shkak se xhumaja është festë dhe ajo si e tillë u përngjan festave, falja e namazit të tyre kryhet paradite.

Imam Ahmedi përsëri citon: *“Sipas asaj që është përmendur nga Ebu Bekri dhe Omeri nuk përbën problem falja e saj para mesit të ditës, sepse ajo është festë dhe festat të gjitha falen në fillim të ditës”⁹².*

Imam Ahmedi -Allahu e mëshiroftë- në këtë citat i referohet edhe veprimit të Ebu Bekrit dhe Omerit -radiallahu anhuma- dhe ai ka për qëllim hadithin e Abdullah bin Sijdan Es-Sulemij (prej tabiinëve të mëdhenj -Allahu e mëshiroftë-) i cili thotë:

“Kam prezantuar në xhuma me Ebu Bekrin Es-Siddijk dhe hytbja me namazin ishin para mesit të ditës. Pastaj kam prezantuar me Omerin dhe hutbja me namazin ishin derisa thoja me vete: u bë mesi i ditës. Pastaj kam prezantuar me Uthmanin dhe hytbja e tij me namazin ishin derisa thoja: kaloi mesi i ditës. Nuk kam parë askënd prej tyre të kritikonte tjetrin”⁹³.

Kështu ka qenë falja e xhumasë në kohën e profetit -alejhi selam- dhe të halifeve të drejtë pas tij. Ndërsa sot, xhumaja falet vetëm në kohën e drekës dhe kjo gjë nuk përbën aspak problem,

⁹¹ Shih librin Fet'h El-Barij i Ibn Rexhepit: 8/177.

⁹² Shih librin Fet'h El-Barij i Ibn Rexhepit: 8/177.

⁹³ E transmeton Ibn Ebij Shejbe, Darakutnij dhe e saktëson sheikh Albani.

sepse si koha e namazit të drekës ashtu dhe koha para saj është kohë e faljes së xhumasë. Mirëpo, lejimi i saj para kohës së drekës duhet të jetë i njohur për besimtarët qoftë dhe vetëm teorikisht, sepse ndonjëherë edhe mund të jetë e nevojshme dhe ja disa shembuj:

1- Kur bashkohen festa e xhumasë me festën e Bajramit

Kur festa e bajramit bie ditën e xhuma, atyre që vijnë nga rrethinat e një vendi u mjafton namazi i bajramit edhe për xhumanë, sepse koha e tyre është e njëjtë.

Ibn Abasi, Ebu Hurejra, Ibn Umeri, Zejd bin Erkam -radiallahu anhum- tregojnë se profeti -alejhi selam- në një rast të tillë ka thënë:

“U janë bashkuar juve në këtë ditë dy festa. Ai i cili nuk do të vijë më, i mjafton ky namaz edhe për xhumanë. Ndërsa ne do ta falim edhe atë në dashtë Allahu i madhëruar”⁹⁴.

2- Kur bën vapë

Në vendet që bën vapë, imami mund ta shpejtojë faljen e xhumasë duke i mbledhur njerëzit paradite, siç ka bërë sahabiu i nderuar Abdullah bin Mesudi -radiallahu anhu-.

Abdullah bin Seleme (tabi’in në kohën e tij) tregon: “*Abdullah bin Mesudi na e ka falur xhumanë në kohën e duhasë (d.m.th: herët paradite) dhe na tha: Pata frikë se mos ju mundonte vapa*”⁹⁵.

⁹⁴ E transmeton Ebu Daudi, Ibn Maxhe dhe e saktëson sheikh Albani.

⁹⁵ E transmeton Ibn Ebij Shejbe dhe e saktëson sheikh Albani.

Një veprim i tillë është transmetuar edhe nga Muavija -radiallahu anhu- siç tregon Said bin Suejd (tabi'in i njohur -Allahu e mëshiroftë-): “*Muavija –radiallahu anhu- na e ka falur xhumanë në kohën e duhasë (d.m.th: paradite)*”⁹⁶.

3- Kur imami ka ndërmend të udhëtojë

Nëse imami është për udhëtim dhe do që ta mbajë vet xhumanë, atëherë ai fal xhumanë më herët se koha e namazit të drekës dhe pastaj niset siç ka bërë Uthmani -radiallahu anhu-.

Ibn Ebij Selijt (tabiin i kohës së tij -Allahu e mëshiroftë-) tregon se Uthmani -radiallahu anhu- ka falur xhumanë në Medine dhe pastaj ka falur namazin e ikindisë në Melel (emër vendi)⁹⁷.

Imam Ibn Rexhep El-Hanbelij në shpjegim të këtij transmetimi thotë: “*Nga Medina deri në Melel janë 22 milje apo 18 milje. Është larg logjikës që ai ta ketë bërë këtë distancë pas zenitit (që do të thotë se ai e ka falur xhumanë më herët se në kohën e drekës)*”⁹⁸.

Pra, xhumaja mund të falet, edhe paradite, edhe në kohën e drekës. Si përfundim, imam Ibn Rexhebi -Allahu e mëshiroftë-në sqarimin e këtij gjykimi thoshte: “*Ai që e lejon faljen e saj edhe para mesit të ditës ka punuar me të gjitha argumentet, pa refuzuar asnjë prej tyre*”⁹⁹.

⁹⁶ E transmeton Ibn Ebij Shejbe dhe e saktëson sheikh Albani.

⁹⁷ E transmeton imam Maliku.

⁹⁸ Shih librin e autorit me titull “Fet’h El-Barij”: 8/174.

⁹⁹ Shih librin e autorit me titull “Fet’h El-Barij”: 8/172.



Hytbja e xhumasë

Me fjalën *Hytbe* emërtohet këshilla e imamit për besimtarët e mbledhur në xhami ditën e Xhuma, siç emërtohen me të gjithashtu dhe këshillat e tij përgjatë ditëve të festave të tjera si Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami. Hytbja është karakteristikë e namazeve të festave dhe i zbukuron ato me këshilla të dobishme për besimtarët, sidomos kjo e xhumasë, sepse radha e saj ndryshe nga ato të tjerat, është para namazit dhe fillon menjëherë pas ezanit të xhumasë. Ajo është përmendur në ajetin e xhumasë së bashku me ezanin e saj, ku thuhet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ

“O ju që keni besuar! Kur të thirret për në namaz ditën e xhuma (d.m.th: kur të thirret ezani i saj), nxitoni për në përkujtimin e Allahut dhe lëreni tregtinë!”¹⁰⁰.

Fjala e Allahut [**nxitoni për në përkujtimin e Allahut**] do të thotë për në hytbe siç tregon Muxhahidi -Allahu e mëshiroftë-komentues i njohur i Kuranit.

¹⁰⁰ Suretu El-Xhumuah: 9.

Përfshirja e hytbes në përmbajtjen e këtij ajeti e ka bërë shumicën e dijetarëve të Islamit të gjykojnë se prezantimi në hytbe është detyrë siç është detyrë edhe për imamin mbajtja e saj çdo të xhuma, sepse profeti -alejhi selam- asnjëherë nuk e ka lënë atë.

Karakteristikat e hytbes profetike

Duke parë hadithet e profetit -alejhi selam- gjejmë se hytbia e tij kishte disa karakteristika, prej tyre:

1- E fillonte me falënderimin e Allahut dhe me shehadet

Xhabir bin Abdullah -radiallahu thotë: **“Profeti -alejhi selam- e falënderonte dhe e lavdëronte Allahun në hytbe”**¹⁰¹.

Ndërsa Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **“Çdo hytbe e cila nuk përmban shehadetin është si dora e këputur”**¹⁰².

Fjala e tij [**është si dora e këputur**] dmth: e padobishme për njerëzit si pjesa e këputur e dorës, e cila pas këputjes nuk i bën më dobi as të zotit të saj.

Sheikh Albani, Allahu e mëshiroftë, në lidhje me këtë çështje thoshte: *“Janë për qëllim ato fjalë që thoshte profeti -alejhi selam- në fillim të çdo hytbeje: Falënderimet i takojnë Allahut të madhëruar! Ne atë falënderojmë dhe prej Tij ndihmë e falje kërkojmë, etj.*

¹⁰¹ E transmeton Muslimi.

¹⁰² E transmeton imam Ahmedi, Ebu Daudi etj dhe e saktëson sheikh Albani.

*Ndoshta ky është shkaku që nuk arrihet dobia nga shumë prej mësimëve dhe ligjërimeve, të cilat u jepen nxënësve, pasi nuk përmbajnë këtë tekst hapjeje, sepse profeti -alejhi selam- i kushtonte atij kujdes të veçantë dhe ua mësonte atë shokëve të tij*¹⁰³.

Pra, pas këtij fillimi fshihet begatia e hytbes, madje jo vetëm kaq, sepse këto lloj deklarimesh në tubime të tilla, ngulisin në mendjen e besimtarëve edhe bazat e besimit të tyre.

2- Këshillonte me ajete dhe sure nga Kurani.

Xhabir bin Semura -radiallahu anhu- thotë: “**Profeti -alejhi selam- lexonte Kuran (në hytbe) dhe këshillonte njerëzit me të**”¹⁰⁴.

Jala bin Umeje -radiallahu anhu- thotë: «**E kam dëgjuar profetin -alejhi selam- duke lexuar mbi minber ajetin:**

وَنَادُوا يَا مَالِكُ لِيَقْضِ عَلَيْنَا رَبُّكَ

Ata do të thërrasin: o Malik! Le të na shfarosë Zoti yt!¹⁰⁵»¹⁰⁶.

Ajeti “**Ata do të thërrasin: o Malik! Le të na shfarosë Zoti yt!**” është i sures Ez-Zuhruf dhe bën fjalë për thirrjen e banorëve të zjarrit kur i thërrasin Malikut, rojes së xhehenemit duke iu lutur atij: Më mirë të na shfarosë Allahu sesa të qëndrojmë gjithmonë në dënim!

¹⁰³ Shih librin e autorit me titull “Es-Silsile Es-Sahihah”: 1/326.

¹⁰⁴ E transmeton Muslimi.

¹⁰⁵ Suretu Ez-Zukhruf: 77.

¹⁰⁶ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Ndërsa e bija e En-Numan bin El-Harith -radiallahu anhumathotë: **“Nuk e kam mësuar suren Kaf veçse prej gojës së profetit -alejhi selam- duke mbajtur hytbe me të çdo xhuma”**¹⁰⁷.

Surja Kaf, me të cilën profeti -alejhi selam- mbante shpeshherë hytbe përmban lavdërim për Kuranin, librin e Allahut, vërtetimin e profetësisë së Muhamedit -alejhi selam-, rrëzimin e përgënjeshtimit të ringjalljes, duke u argumentuar me krijimin e qiejve të lartë, tokës dhe përhapjen e bimësisë në të, zbritjes së ujit për t’i dhënë asaj jetë dhe përfitimet që kanë njerëzit prej tyre, të cilat nuk janë më pak të mundshme se sa ringjallja, pasojat e rënda të përgënjeshtimit të popujve të mëparshëm dhe dënimi i tyre, dija e Allahut rreth krijesave të Tij deri dhe çfarë pëshpërisin në vetet e tyre, misteret e vdekjes, dënimi që i pret mohuesit në ahiret dhe tmerret e tij, mirësia që i pret besimtarët në ahiret dhe mrekuillitë e tij, nxitjen e njerëzve për të nxjerrë mësim nga këto përkujtime, nxitjen e profetit -alejhi selam- për të vazhduar në rrugën e përkujtimit të njerëzve, si dhe nxitjen e tij për durim, derisa të bëhet realitet premtimi i Allahut të madhëruar.

Të gjitha këto tematika, secila prej tyre mund të jetë hytbe më vete për t’i mësuar, ndërgjegjësuar dhe nxitur njerëzit për të punuar me to.

Ibn El-Kajimi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me përmbajtjen e hytbeve profetike thotë: *“Profeti -alejhi selam- në hytbet e tij u mësonte atyre bazat e islamit dhe normat e tij. Dhe kur ishte e nevojshme u jepte udhëzime dhe ndalesa të çastit”*¹⁰⁸.

¹⁰⁷ E transmeton Muslimi.

¹⁰⁸ Shih librin e autorit me titull Zad el-Mead: 1/412.

Fjala e tij [të çastit] d.m.th: për nevoja që mund të shfaqen në momentin e hytbes si: rregullat e ndenjes në xhami, falja e dy rekateve para uljes, duaaja për shi nëse është e nevojshme, përkrahja e ndonjë njeriu në nevojë, etj.

Ai në një citat tjetër thotë: “*Hytbet e profetit -alejhi selam-përmbanin: falënderim për Allahun, lavdërim për Të, për mirësitë dhe cilësitë e Tij të larta, mësim të bazave të islamit, përmendje të xhenetit, të xhehenemit dhe të ahiretit, porosi për devotshmëri ndaj Allahut, qartësim të punëve që çojnë në zemërimin e Allahut dhe të atyre që çojnë në fitimin e kënaqësisë së Tij. Kështu ishin hytbet e tij*”¹⁰⁹.

3- I kushtonte rëndësi anës emocionale

Xhabir bin Abdullah -radiallahu anhu- thotë: “**Profeti -alejhi selam- kur mbante hytbe i skuqeshin sytë, ngrinte zërin dhe ashpërsohej sikur po paralajmëronte një ushtri armike**”¹¹⁰.

Mudh’hirudin Ez-Zejdani -Allahu e mëshiroftë- prej dijetarëve të hadithit dhe komentuesve të tij, i cili vdiq në vitin 727 sipas hixhretit, në lidhje me këtë hadith thotë: “*Shkakun e ngritjes së zërit të tij ishte: arritja e fjalëve të veshët e tyre, vlerësimi i lajmit në shpirtrat e tyre dhe ndikimi i tij në zemrat e tyre*”¹¹¹.

Për të pasur gjithashtu një hytbe emocionale, përveç mënyrës së të shprehurit, kërkohet edhe që hytbia të përgatitet mirë dhe

¹⁰⁹ Shih librin e autorit “Zad El-Mead”: 1/181.

¹¹⁰ E transmeton Muslimi.

¹¹¹ Shih librin e autorit “El-Mefatijh Sherh El-Mesabijh”: 2/329.

ligjëruesi i saj të jetë njeri i devotshëm, sepse prej karakteristikave të pandashme të profetit -alejhi selam- ishin dija dhe devotshmëria.

4- Hytbja e tij ishte mesatare

Xhabir bin Semura -radiallahu anhu- tregon: **“Jam falur me profetin -alejhi selam- në namaze. Namazi i tij ishte i mesëm dhe hytbja e tij ishte e mesme”**¹¹².

Imam Neveviu, në lidhje me të mesmen e përmendur në hadith citon: *“Kjo do të thotë se hytbet e tij ishin mes zgjatjes së tepruar dhe shkurtimit me mangësi”*¹¹³.

Është transmetuar nga profeti -alejhi selam- se ka thënë: **“Zgjatja e namazit dhe shkurtimi i hytbes janë shenjë e aftësisë së burrit. Prandaj zgjateni namazin, shkurtoheni hytben dhe dijani se prej të shprehurit bukur ka magji”**¹¹⁴.

Pra, hytbja e shkurtër është shenjë e aftësisë së hatibit (ligjëruesit), sepse i afti është ai i cili njeh kuptimet e fjalëve dhe shprehjet që i përmbajnë ato. Kështu, ai nga njëra anë arrin të shprehet me shprehje të forta, të bukura, ndikuese dhe të dobishme dhe nga ana tjetër nuk do t'i duhet shumë kohë për ta përcjellë mesazhin e tij.

¹¹² E transmeton Muslimi.

¹¹³ Shih librin e autorit me titull “Sherh Muslim”: 6/153.

¹¹⁴ E transmeton Muslimi.

5- Hytben e mbante në këmbë dhe e ndante atë në dy hytbe nëpërmjet një uljeje mes tyre.

Xhabir bin Semura -radiallahu anhu- tregon: “**Profeti -alejhi selam- mbante dy hytbe dhe ulej mes tyre**”¹¹⁵.

Pra, hytbja mbahej në këmbë dhe ulja mes hytbeve shërbente për ndarjen e tyre.

Hytbja e dytë nuk ndryshon nga e para, çka do të thotë se edhe ajo duhet të përmbajë: lavdërimin e Allahut, shehadetin dhe këshilla për besimtarët.

Është pyetur sheikh Albani, Allahu e mëshiroftë: Disa hatibë e veçojnë hytben e dytë për dua? Përgjigja e tij ishte: “*Në fjalët profetike nuk ka dallim mes hytbes së parë dhe të dytë. Që të dyja përmbajnë këshillim*”¹¹⁶.

Këto janë disa karakteristika të hytbes profetike për të cilat kanë shumë nevojë hatibët dhe lus Allahun e madhëruar t’u japë atyre sukses në ligjërimet e tyre, sepse ata në këtë detyrë zëvendësojnë profetin e këtij ymeti, Muhamedin -alejhi selam-!

Si duhet të qëndrojmë gjatë hytbes?

Që hytbet të arrijnë qëllimin e tyre, kërkohet prej besimtarëve të heshtin gjatë kohës që hoxha ligjëron dhe të dëgjojnë me vëmendje fjalët e tij.

¹¹⁵ E transmeton Muslimi.

¹¹⁶ Shih librin Xhami Turath El-Albanij: 6/129.

Kjo porosi është përmendur në Kuran, ku thuhet:

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Kur të lexohet Kurani, dëgjojeni atë me vëmendje dhe heshtni, se ndoshta do të mëshiroheni!”¹¹⁷.

Muxhahidi, komentuesi i njohur i Kuranit, në lidhje me këtë ajet thotë: *“Kur të lexohet Kurani është detyrë të heshtësh në dy raste: në namaz kur lexon imami dhe në xhuma kur mban hytben hatibi”¹¹⁸.*

Pra, Allahu i madhëruar në këto dy momente kur lexohet Kurani, ku njëri prej tyre është hytbja, urdhëron për dëgjim me vëmendje dhe heshtje. Ai premton mëshirë për ata që e zbatojnë këtë porosi, sepse fjala [**ndoshta**] e përmendur në ajet, kur është prej Allahut është premtim.

Ibn El- Kajimi -Allahu e mëshiroftë- thotë: *“Fjala [ndoshta] në lidhje me Allahun është detyrë (që do të thotë se patjetër do të realizohet, nëse plotësohet kushti i saj)”¹¹⁹.*

Dy kushtet e këtij premtimi janë:

1- Dëgjimi me vëmendje.

2- Heshtja.

Dëgjimi me vëmendje është bërë kusht për shkak se pa të nuk arrihet ndikimi i Kuranit në zemra dhe përkujtimi me të. Allahu

¹¹⁷ Suretu El-Earaf: 204.

¹¹⁸ E transmeton imam Taberiu në tefsirin e tij: 13/351.

¹¹⁹ Shih librin e autorit me titull “’Ilam El-Muekkijn”: 4/99.

i madhëruar në Kuran, kur tregon se kush përfiton prej Kuranit, thotë:

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرَى لِمَنْ كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ

“Vërtet, këtu ka përkujtim për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe është prezent”¹²⁰.

Ibn El-Kajim, në lidhje me këtë ajet sqaron: *“Që të përfitojë njeriu prej Kuranit duhet të ketë zemër të shëndoshë, të dëgjojë me vëmendje dhe zemra e tij të jetë prezente (d.m.th: jo gafil dhe i shkujdesur)”¹²¹.*

Ndërsa heshtja është bërë kusht për shkak se të folurit është pengesë e dëgjimit me vëmendje, sepse njeriu nuk bën dot dy punë të kundërta njëkohësisht. Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

مَا جَعَلَ اللَّهُ لِرَجُلٍ مِنْ قَلْبَيْنِ فِي جَوْفِهِ

“Nuk i ka dhënë Allahu asnjë njeriu dy zemra në kraharonin e tij”¹²².

Ibn El-Kajimi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë ajet sqaron: *“Zemra nuk merr dot veçse një drejtim. Nëse ajo anon nga një anë, nuk anon dot edhe nga një anë tjetër (njëkohësisht). Njeriu nuk ka dy zemra që me njërën t'i bindet Allahut dhe të zbatojë porosinë e Tij dhe me tjetrën dikujt tjetër”¹²³.*

¹²⁰ Suretu Kaf: 37.

¹²¹ Shih librin e autorit me titull “El-Feuaid”: 3.

¹²² Suretu El-Ahzab: 4.

¹²³ Shih librin e autorit me titull “Reudat El-Muhibbin”: 288.

Në hadithet e profetit -alejhi selam- jemi njoftuar se heshtja kërkohet edhe ndaj veprimeve të gabuara të të tjerëve. Psh: kur dikush flet gjatë hytbes, nuk bën t'i flasësh për ta pushuar, sepse profeti -alejhi selam- thotë: **“Nëse i thua shokut tënd: hesht, kur imami është duke mbajtur hytbe, ke bërë veprim të kotë”**¹²⁴.

Sheikh Albani -Allahu e mëshiroftë- sqaron: *“T’i thuash tjetrit: Hesht! Është urdhërim për në të mira, por që në këtë rast është ndaluar, në mënyrë që t’i jepet rëndësi dëgjimit me vëmendje ndaj hytbes”*¹²⁵.

Ndalimi i fjalëve përfshin edhe ndalimin e çdo veprimi tjetër, i cili nuk është fjalë, por që e shkujdes njeriun apo e preokupon atë nga dëgjimi me vëmendje. Profeti -alejhi selam- thotë: **“Kush prek guralecët, ka bërë punë të kotë”**¹²⁶.

Fjala guralecët është përmendur në hadith, sepse xhamia në atë kohë ka qenë e shtruar me rërë dhe këtë gjykim e merr çdo veprim tjetër i kotë.

A arrihet shpërblimi i xhumasë për atë që bën veprime të kota gjatë hytbes dhe a i quhet xhumaja atij?

Thamë që dëgjimi me vëmendje dhe heshtja sipas ajetit të lartpërmendur janë kusht për arritjen e mëshirës së Allahut të madhëruar. Mirëpo, jemi njoftuar se ato janë kusht edhe për arritjen e shpërblimit të xhumasë.

¹²⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹²⁵ Shih librin Xhami Turath El-Albanij: 2/142.

¹²⁶ E transmeton Muslimi.

Profeti -alejhi salam- thotë: «**Në Xhuma marrin pjesë tre lloje njerëzish:**

Ai që bën veprime të kota dhe vetëm ato fiton prej saj.

Ai që merret me dua, të cilat Allahu, nëse do ia jep atij dhe nëse do ia pengon.

Ai që hesht, dëgjon me vëmendje, rri i qetë, nuk kapërcen mbi qafën e ndonjë myslimani dhe nuk mundon njeri, xhumaja për të është pastrim deri në xhumanë tjetër duke shtuar dhe tre ditë sepse Allahu i madhëruar thotë:

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ عَشْرُ أَمْثَالِهَا

“Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish”¹²⁷,¹²⁸.

Shihet qartë nga hadithi se lloji i parë d.m.th: ai që është marrë me punë të kota gjatë hytbes është i përjashtuar nga shpërblimi.

Ndërsa lloji i dytë d.m.th: ai që është marrë me dua apo dhe me ndonjë punë tjetër të mirë e cila është ibadet si psh: tespih. Edhe ky lloj nuk shpërblehet për xhumanë, madje kjo gjë mund t’ua pengojë atyre edhe pranimin e ibadetit tjetër me të cilin janë marrë, mirëpo kjo mbetet në dëshirën e Allahut të madhëruar.

Ndërsa lloji i tretë d.m.th: ai i cili i është përkushtuar plotësisht xhumasë dhe normave të saj, është ai që arrin shpërblimin e premtuar të xhumasë.

¹²⁷ Suretu El-Enam: 160.

¹²⁸ E transmeton imam Ahmedi, Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

Çështja tjetër e kësaj teme është: A ndikojnë punët e kota edhe në refuzimin e plotë të xhumasë?

Është transmetuar nga profeti -alejhi salam- fjala e tij: **“Kush bën punë të kota, nuk ka xhuma për të”**¹²⁹.

Ky hadith, saktësimi i tij është i diskutueshëm në mesin e dijetarëve, mirëpo sheikh Albani -Allahu e mëshiroftë- mendon se ai mund të saktësohet për nga ana e përmbajtjes duke e krahasuar me hadithet e tjera dhe se fjala e tij [**nuk ka xhuma për të**] ka të bëjë me shpërblimin që do të thotë se xhumaja e tij pranohet, por ai nuk shpërblehet për të me shpërblim të plotë.

Shpërblimi i xhumasë në këtë rast është sa namazi i drekës, sepse në një hadith tjetër i cili ka të bëjë me të njëjtën çështje thuhet:

“Kush bën punë të kota dhe kapërcen mbi qafat e njerëzve, xhumaja për të është sa namazi i drekës”¹³⁰.

Kjo ndoshta se xhumaja nuk përbëhet vetëm nga hytbja. Ajo ka edhe namazin, madje namazi është kryesori, kështu që do të mbetet për të shpërblimi i namazit, nëse ai nuk do të bëjë të njëjtën gjë edhe në namaz dhe Allahu e di më së miri!

¹²⁹ E transmeton Ahmed, Ebu Daudi etj.

¹³⁰ E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.



Namazi i xhumasë

Namazi i xhumasë është falja e dy rekateve namaz -pas hytbes- me xhematin e mbledhur në xhami dhe me imam, siç thoshte Omeri -radiallahu anhu-:

“Namazi i udhëtimit është dy rekate. Namazi i Fitrit është dy rekate. Namazi i Kurbanit është dy rekate. Dhe namazi i xhumasë është dy rekate. Ato janë të plota dhe jo të shkurtuara. E thënë kjo nga goja e profetit -alejhi selam-”¹³¹.

Profeti -alejhi selam- në këtë namaz e ka pasur adet leximin e disa pjesëve të veçanta kuranore. Ai, herë lexonte suren El-Xhumuah dhe suren El-Munafikun dhe herë lexonte suren El-Ala dhe suren El-Gashije, me të cilat -siç duket nga përmbajtja e tyre- donte t'i kujtonte besimtarëve veçoritë e xhumasë që t'i nxiste ata për vlerësimin e saj.

Ibn Hubejra (dijetar i madh i kohës së dinastisë abasite, i cili vdiq në vitin 560 sipas hixhretit -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me dy suret e para (El-Xhumuah dhe El-Munafikun), thotë:

¹³¹ E transmeton imam Ahmedi, Nesaiu, etj dhe e saktëson sheikh Albani.

“Leximi i sures El-Xhumuah dhe El-Munafikun në namazin e xhumasë, i përshtatet përmendjes së xhumasë dhe qortimin e atyre që ranë në kundërshtim në lidhje me të”.

Ndërsa imam Es-San’anij (dijetar shumë i njohur i Jemenit, i cili ka vdekur në vitin 1182 sipas hixhretit) në lidhje me dy suret e tjera (El-Ala dhe El-Gashije), thotë:

“Në këto dy sure ka përkujtim të njerëzve me tmerret e ahiretit, si dhe me premtimet dhe kërcënimet e tij, leximi i të cilave i përshtatet atij bashkimi në atë namaz”.

Ky namaz është përmendur në Kuran së bashku me ezanin dhe hytben e tij, ku Allahu i madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ * فَإِذَا قُضِيَتِ الصَّلَاةُ فَانْتَشِرُوا فِي الْأَرْضِ وَابْتَغُوا مِنْ فَضْلِ اللَّهِ وَاذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“O ju që keni besuar! Kur të thirret për në namaz ditën e xhuma (d.m.th: kur të thirret ezani i saj), nxitoni për në përkujtimin e Allahut dhe lëreni tregtinë! Kështu është më mirë për ju, nëse e dini! * Kur të keni kryer namazin (d.m.th: namazin e xhumasë), atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni prej mirësive të Tij! Kujtojeni shumë Allahun se ndoshta do të shpëtoni!”¹³².

Ezani dhe namazi i xhumasë në këto ajete janë përmendur qartë, ndërsa hytbia e saj përfshihet te fjala e Allahut [nxitoni

¹³² Suretu El-Xhumuah: 9-10.

për në përkujtimin e Allahut] siç është sqaruar edhe më herët te çështja e hytbes.

Fjala e Allahut [**Kur të thirret për në namaz ditën e xhuma**] do të thotë se qëllimi kryesor i bashkimit të njerëzve ditën e xhuma është namazi i xhumasë, edhe pse ajeti më pas nxit edhe për hytben.

Ky fakt na çon drejt një çështjeje të rëndësishme dhe të nevojshme për t'u njohur nga besimtarët: A është kusht për faljen xhumasë mbajtja e hytbes para saj?

Nevoja për hytbe ndihet shumë kur në mesin e besimtarëve të mbledhur në xhami mungon hatibi (emërtim fetar për mbajtësin e hytbes ditën e xhuma).

Imam Sheukani, dijetar i njohur i ymetit nga krahina e Jemenit -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje thotë: *“Është provuar me prova të shumta të cilat japin gjykim të prerë se profeti -alejhi selam- asnjëherë nuk e ka lënë hytben në namazin e xhumasë.*

Kështu, xhumaja e porositur nga Allahu i madhëruar është falja e dy rekateve namaz së bashku me një hytbe para saj. Për këtë ka urdhëruar edhe Allahu i madhëruar në librin e Tij të çmuar kur urdhëron për të nxituar te përkujtimi i Allahut. Hytbia është prej përkujtimit të Allahut, por edhe nëse ajo nuk është për qëllim nga ajeti, ajo prapë është detyrë. Ndërsa konsiderimi i saj si një prej kushteve të xhumasë nuk qëndron”¹³³.

Pra, hytbia është detyrë për xhuma dhe besimtarët duhet të gjejnë hatib për të, mirëpo ajo nuk është kusht prej kushteve të

¹³³ Shih librin e autorit me titull “Es-Sejl El-Xherrar”: 182.

xhumasë, që do të thotë se, nëse nuk gjendet hatib për xhumanë, nuk duhet të lihet namazi i xhumasë për shkak se nuk ka hatib për të mbajtur hytben para namazit.

Kur arrihet namazi i xhumasë?

Kjo pyetje ka të bëjë me ata që vonohen për në xhuma: Kur konsiderohet dikush se e ka arritur xhumanë dhe kur konsiderohet se e ka humbur atë?

I vonuari për në xhuma, nëse arrin një rekat nga namazi i xhumasë, e ka arritur xhumanë, siç thotë sheikhu Islam Ibn Tejmija në fetvatë e tij: «*Xhumaja dhe xhemati nuk arrihen veçse nëse arrihet një rekat, sepse sheriati nuk e ka llogaritur arritjen e kohës së ndonjë namazi nëse dikush arrin më pak se një rekat, siç tregon Ebu Hurejra radiallahu anhu: “**Kush arrin nga namazi i ikindisë para perëndimit të diellit një rekat e ka arritur namazin dhe kush arrin nga namazi i sabahut para lindjes së diellit një rekat e ka arritur namazin**”*¹³⁴,¹³⁵.

Arritja e namazit të xhumasë me arritjen e një rekati ka qenë edhe fetvaja e disa sahabëve si Abdullah bin Umr, Abdullah bin Mes’udi dhe Enes bin Maliku -radiallahu anhum- dhe nuk dihet t’i ketë kundërshtuar njeri ata në kohën e tyre.

Një rekat në gjuhën e shariatit quhet i arrirë me kapjen e rukusë, sepse Ebu Hurejra -radiallahu anhu- në një hadith tjetër tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: “**Kur ta gjeni imamin**

¹³⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹³⁵ Shih librin Mexhmu El-Fetaua: 23/330.

në këmbë, apo në ruku, apo në sexhde, apo ulur, ndiqeni atë dhe mos e llogarisni sexhden nëse nuk keni kapur rukunë¹³⁶.

Kështu, bazuar në këto gjykime profetike themi se, kush e arrin imamin në rukunë e fundit (d.m.th atë të rekatit të dytë) e ka arritur xhumanë dhe nuk i mbetet tjetër veçse të plotësojë rekatën e humbur. Ndërsa ai që e arrin imamin pas rukusë së fundit nuk e ka arritur xhumanë dhe për pasojë ai nuk mund të mjaftohet me dy rekate xhuma, por duhet të falë katër rekate namaz dreke siç thoshte Ibn Mes'udi -radiallahu anhu-: **“Kujt i ikin dy rekatet e xhumasë, të falë katër rekate (d.m.th namaz dreke)”**¹³⁷.

A kërkohet namazi i drekës për atë që ka falur xhumanë?

Namazi i drekës u kërkohet vetëm atyre që nuk kanë falur xhumanë, sepse nuk është transmetuar nga profeti -alejhi selam- të ketë falur ndonjëherë namazin e drekës pas faljes së xhumasë.

Ja çfarë tregohet nga sahabët dhe tabiinët në lidhje me gratë në kohën e tyre!

Abdullah ibn Mesudi -radiallahu anhu- i porosiste ato: **“Nëse faleni ditën e xhuma me imamin, faluni me namazin e tij dhe nëse faleni në shtëpi falni katër rekate”**¹³⁸.

Hasen Basriu, tabiin i njohur -Allahu e mëshiroftë- thoshte:

¹³⁶ E transmeton Bejhakui dhe e saktëson sheikh Albani.

¹³⁷ E transmeton Taberaniju dhe e saktëson sheikh Albani.

¹³⁸ E transmeton Ibn Ebij Shejbe dhe e saktëson sheikh Albani.

“Gratë e muhaxhirëve falnin xhumanë me profetin -alejhi salam- dhe e llogarisnin atë në vend të drekës”¹³⁹.

Gratë që përmenden në hadith janë prej asaj kategorie njerëzish të cilët nuk e kanë detyrë namazin e xhumasë dhe kanë detyrë namazin e drekës, e megjithatë ato kur prezantonin në xhuma dhe falnin namazin e xhumasë nuk e falnin namazin e drekës, çfarë do të thotë se ditën e xhuma kërkohet vetëm njëra nga të dyja: ose xhumaja, ose dreka dhe jo të dyja bashkë.

Ky gjykim është ai që kuptohet edhe nga fjala e Allahut të madhëruar kur përmend namazin e xhumasë dhe thotë:

فَإِذَا قُضِيَتِ الصَّلَاةُ فَانْتَشِرُوا فِي الْأَرْضِ وَابْتَغُوا مِنْ فَضْلِ اللَّهِ

“Kur të keni kryer namazin (d.m.th: namazin e xhumasë) atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni prej mirësive të Tij!”¹⁴⁰.

Arrak bin Malik, prej tabiinëve të devotshëm, i cili ka vdekur rreth viteve 100 sipas hixhretit-Allahu e mëshiroftë- pasi falte xhumanë kujtonte këtë ajet dhe qëndronte te dera e xhamisë dhe lutej: *“O Allah, unë iu përgjigja ftesës Tënde, kreu detyrën Tende dhe u shpërndava siç më ke urdhëruar, atëherë më furnizo me të mira, sepse Ti je më i miri furnizues!”¹⁴¹.*

Pra, urdhri i Allahut për t’u shpërndarë pas xhumasë tregon se nuk ka namaz dreke për atë që fal namazin e xhumasë.

¹³⁹ E transmeton ibn Ebij Shejbe dhe e saktëson sheikh Albani.

¹⁴⁰ Suretu El-Xhumuah: 10.

¹⁴¹ Shih tefsir Ibn Ebij Hatim: 10/3356.

A ka namaz synet pas xhumasë?

Kur përmendëm ezanin e xhumasë thamë se profeti -alejhi selam- dhe sahabët nuk kanë pas falur namaz synet të xhumasë mes ezanit dhe namazit të saj, sepse kur thirrej ezani i xhumasë ai ishte i ulur në minber dhe priste përfundimin e ezanit për të filluar hytben. Ndërsa në lidhje me kohën pas saj është transmetuar nga profeti -alejhi selam- fjala e tij: “**Kush do të falet pas xhumasë, të falë katër rekate**”¹⁴², siç është transmetuar gjithashtu nga Abdullah bin Umeri -radiallahu anhu- se: “**Profeti -alejhi selam- falte xhumanë, pastaj largohet dhe falte dy rekate në shtëpi**”¹⁴³.

Këto hadithe tregojnë se pas xhumasë mund të falen: ose dy rekate, ose katër rekate dhe nuk tregojnë se ka dallim mes xhamisë dhe shtëpisë në lidhje me numrin e rekateve siç mendojnë disa dijetarë.

Sheikh Albani -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë çështje, pas një studimi të gjatë, thotë: “*Nëse fal pas xhumasë dy apo katër rekate në xhami, lejohet, ose edhe në shtëpi (d.m.th të njëjtin numër dy apo katër rekate) dhe kjo është më e mira (d.m.th falja e tyre në shtëpi është më e mirë se në xhami)*”¹⁴⁴.

¹⁴² E transmeton Muslimi.

¹⁴³ E transmeton Muslimi.

¹⁴⁴ Shih fjalët e autorit në librin e tij “Tamam El-Minne”: 341.



Mirësitë e përkushtimit ndaj xhumasë

Përkushtimi ndaj xhumasë ka disa mirësi, për të cilat ka njoftuar profeti -alejhi selam- dhe sa më i madh të jetë përkushtimi, aq më shumë mirësi ka. Prej këtyre mirësive veçojmë:

1- Mirësia e atij që bashkon mes guslit dhe vajtjes herët në xhami.

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **“Kush lahet ditën e xhuma si gusli i xhunubit, pastaj shkon në xhami, është sikur ka bërë kurban një deve. Ai që shkon orën e dytë është sikur ka ofruar kurban një lopë. Ai që shkon në orën e tretë është sikur ka bërë kurban një dash me brirë. Ai që shkon në orën e katërt është sikur ka ofruar kurban një pulë. Dhe ai që shkon në orën e pestë është sikur ka ofruar kurban një vezë”**¹⁴⁵.

Në një version tjetër të hadithit thuhet: **“Ditën e xhuma, në çdo derë prej dyerve të xhamisë ka melaike që regjistrojnë**

¹⁴⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

njerëzit sipas radhës që vijnë dhe kur imami ngjitet në minber ata i mbyllin regjistrat dhe vijnë për të dëgjuar përkujtimin e Allahut. Ai që vjen në orën e parë është si ai që bën kurban një deve.... -vazhdon hadithi me të njëjtin tekst siç është përmendur më lart-”¹⁴⁶.

Ibn Haxher El-Askalanij, komentuesi i njohur i haditheve -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë hadith thotë: “*Në këtë hadith ka nxitje për guslin e ditës së xhuma, mirësinë e tij dhe mirësinë e vajtjes herët në xhuma dhe se kjo mirësi e përmendur arrihet duke bashkuar mes të dyjave. Kështu, duhen kuptuar versionet e tjera, të cilat njoftojnë për arritjen e kësaj mirësie me vajtjen herët e që nuk e kushtëzojnë atë me guslin*”¹⁴⁷.

Vlerën e këtij veprimi ia shton edhe fakti se, për shkrimin e mirësisë së tij janë caktuar engjëj të posaçëm, të cilët siç duket nga ana e jashtme e hadithit janë të tjerë dhe jo ata ruajtësit.

2- Mirësia e atij që i kushton rëndësi pastërtisë, zbukurimit, ecjes me qetësi për në xhami, faljes së nafileve para xhumasë dhe edukatës së ndenjes në xhami.

Në lidhje me këtë mirësi kanë ardhur disa hadithe, prej tyre:

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: “**Kush merr gusl ditën e xhuma, pastaj vjen në xhuma dhe fal aq sa i ka caktuar Allahu, pastaj hesht derisa imami të mbarojë hytben dhe pastaj falet me të, i falen gjynahet mes**

¹⁴⁶ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹⁴⁷ Shih librin e autorit Fet’h El-Barij: 2/368.

asaj xhumaje dhe xhumasë tjetër (*d.m.th: xhumasë së kaluar*) **dhe tre ditë më shumë**¹⁴⁸.

Selman El-Farisij -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi salam- ka thënë: **“Kush lahet ditën e xhuma, pastrohet aq sa mundet, parfumoset nga parfumi që ka, pastaj shkon në xhami dhe nuk ndan mes dy vetave, fal aq sa i ka caktuar Allahu të falë dhe hesht kur flet imami, veçse i falen atij gjynahet mes asaj xhumaje dhe tjetres**¹⁴⁹.

Abdullah bin Amr bin El-As -radiallahu anhu- tregon: **“Kush lahet ditën e xhuma, parfumoset me parfumin që gjen te gruaja e tij** (*d.m.th: në shtëpinë e tij*), **vesh rrobat më të bukura që ka, pastaj nuk kapërcen mbi qafat e njerëzve dhe as merret me punë të kota gjatë përkujtimit** (*d.m.th: gjatë hytbes*), **xhumaja për të është falje mes dy xhumave**¹⁵⁰.

Ebu Ejub El-Ensari shton në këtë hadith: **“... pastaj ecën për në xhami me qetësi dhe nuk mundon njeri... ”**¹⁵¹.

Ibn Haxheri -Allahu e mëshiroftë- përsëri citon: *“Nga gjithë çfarë ka ardhur prej argumenteve përfitohet se, shlyerja e gjynaheve nga xhumaja në xhuma është e kushtëzuar me bashkimin e të gjithë punëve të përmendura: gusli, pastrimi, parfumosja, veshja e rrobave më të mira, ecja me qetësi, moskapërcimi i njerëzve, mosndarja mes dy vetave, mosmundimi i njerëzve, falja nafile (para xhumasë), heshtja dhe mosmarrja me punë të kota*¹⁵².

¹⁴⁸ E transmeton Muslimi.

¹⁴⁹ E transmeton Buhariu.

¹⁵⁰ E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

¹⁵¹ E transmeton imam Ahmed i dhe e saktëson sheikh Shuajb El-Arnaut.

¹⁵² Shih librin e autorit me titull Fet'h El-Barij: 2/372.

3- Mirësia e atij që bashkon mes vajtjes herët dhe dëgjimit të hytbes me vëmendje duke shtuar këtu guslin dhe ecjen në këmbë për në xhami.

Eus bin Eus -radiallahu anhu- tregon se ka dëgjuar profetin -alejhi selam- të thotë: **“Kush lahet mirë ditën e xhuma, nisat herët, ecën në këmbë dhe jo hipur, afrohet nga imami duke dëgjuar me vëmendje dhe nuk merret me kotësira, për çdo hap që hedh i shkruhet sikur ka bërë punën e një viti, shpërblimin e agjërimit dhe të faljes së tij (të vitit)”**¹⁵³.

Imam Sheukani -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me këtë hadith thotë: *“Hadithi tregon se bashkimi mes këtyre punëve është shkak për arritjen e atij shpërblimi”*¹⁵⁴.

Fjala e profetit -alejhi selam- [**për çdo hap që hedh i shkruhet sikur ka bërë punën e një viti, shpërblimin e agjërimit dhe të faljes së tij**] d.m.th: shpërblimin e agjërimit dhe të namazit të natës së një viti, sikur ai të kishte agjëruar dhe falur çdo ditë dhe natë të tij për çdo hap që hedh. Ky shpërblim është shpërblim i rrallë në shariat, madje i padëgjuar për ndonjë punë tjetër veç saj siç thotë El-Mul-la Ali El-Karij -Allahu e mëshiroftë-: *“Disa prej dijetarëve kanë thënë: Nuk kemi dëgjuar në shariat ndonjë hadith tjetër të saktë të përmbajë shpërblim si ky, prandaj duhet të punohet me to që ai të arrihet”*¹⁵⁵.

¹⁵³ E transmeton Imam Ahmedi, Ebu Daudi, Ibn Maxhe dhe e saktëson sheikh Albani.

¹⁵⁴ Shih librin e autorit me titull Nejl El-Eutar: 1/296.

¹⁵⁵ Shih fjalët e autorit në librin me titull Merkat el-Mehatijh: 3/1035.



Ora e përgjigjes së duasë (lutjes) ditën e xhuma

Pas mbarimit të namazit të xhumasë nuk mbetet gjë tjetër prej angazhimeve të saj, veçse shfrytëzimi i orës së pranimit të duasë në këtë ditë -siç ka ardhur në hadithet e sakta-, prej tyre:

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se ka dëgjuar profetin -alejhi selam- duke thënë: **“Në ditën e xhuma ka një orë, gjatë së cilës kushdo që qëllon duke u falur dhe i lutet Allahut për diçka ia jep atë”**¹⁵⁶.

Në lidhje me caktimin e kësaj ore janë disa mendime në mesin e dijetarëve të islamit, por dy mendimet më me bazë janë si më poshtë:

Mendimi i parë: Ora e përgjigjes së duasë është koha kur imami ulet në minber derisa të mbarojë namazi i xhumasë.

Ky mendim mbështetet në një hadith, ku Abdullah bin Umr -radiallahu anhu- pyet Ebu Burden, të birin e Ebu Musa El-Esh'arij -radiallahu anhu-: *“A e ke dëgjuar babanë tënd të thotë*

¹⁵⁶ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

*ndonjë gjë nga profeti -alejhi selam- për orën e xhumasë? Ai i thotë: E kam dëgjuar atë duke thënë se e ka dëgjuar profetin -alejhi selam- të thotë: **Ajo (orë) është mes kohës kur imami ulet në minber deri kur mbaron namazi***¹⁵⁷.

Kjo përgjigje mendohet të mos jetë nga profeti -alejhi selam- dhe imam Muslimi, i cili e ka transmetuar atë, është kritikuar për përfshirjen e këtij hadithi mes haditheve të profetit -alejhi selam-, sepse ky hadith sipas një transmetimi tjetër shfaqet si mendim i Ebu Musa El-Esh'arij -radiallahu anhu- dhe jo fjalë profetike. Kështu citon imami i madh i hadithit Derakutni dhe e pason atë imami i hadithit në kohën tonë sheikh Albani -Allahu e mëshiroftë-¹⁵⁸.

Mendimi i dytë: Ora e përgjigjes së duasë është ora e fundit e xhumasë para perëndimit të diellit.

Ky mendim mbështetet te një hadith i Xhabir bin Abdilah -radiallahu anhu- se profeti -alejhi selam- ka thënë: **“Dita e xhumasë është 12 orë. Nuk ka mysliman që i lutet Allahut për diçka veçse ia jep atij. Kërkojeni atë në orën e fundit pas ikindisë**”¹⁵⁹.

Mendimi i dytë është mendimi më i saktë i dhënë për këtë çështje dhe kjo për disa arsye:

E para: Hadithi i Ebu Musa El-Esh'arij -radiallahu anhu-, në të cilin mbështetet mendimi i parë mund të mos jetë fjalë

¹⁵⁷ E transmeton Muslimi.

¹⁵⁸ Shih librin “Illel Ed-Darakutnij”: 7/212 dhe librin “Daif Ebu Daud” i sheikh Albanit: 1/397.

¹⁵⁹ E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh El-Albani

e profetit -alejhi selam- por fjalë e vet Ebu Musa El-Esh'arij -radiallahu anhu-, ndërsa hadithi i Xhabirit -radiallahu anhu- është padyshim fjalë profetike, sepse nuk kritikohet nga ana e zinxhirit të transmetimit të tij.

E dyta: Ky mendim përkrahet edhe nga fjala e një sahabiu të nderuar Abdullah bin Selam -radiallahu anhu-, i cili e konfirmon caktimin e kësaj ore edhe te librat e mëparshëm të Allahut, sepse ai njihet për diturinë e tij në lidhje me ato libra.

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se është takuar njëherë me Kab El-Ah'bar (tabi'in i njohur gjithashtu për njohuritë e tij në lidhje me librat e mëparshëm të Allahut) dhe kanë biseduar me të në lidhje me orën e përgjigjes së duasë ditën e xhuma. Ai thotë: *“Kabi më tha: Ajo është një ditë në vit. Unë i thashë: Jo. Ajo është çdo xhuma. Atëherë Kabi lexoi Teuratin dhe më tha: Të vërtetën ka thënë i Dërguari i Allahut. Pastaj takova Abdullah bin Selamin -radiallahu anhu- dhe i tregova për bisedën time me Kabin në lidhje me xhumanë dhe se Kabi më tha: Ajo është një ditë në vit. Ai më tha: E ka gabim Kabi. I thashë: Ai pastaj lexoi Teuratin dhe më tha se është në çdo xhuma. Ai më tha: Mirë e ka Kabi.*

Pastaj Abdullah bin Selami më tha: Unë e di se cila orë është ajo. I thashë: Ma trego dhe mos u trego koprrac ndaj meje! Ai më tha: Ajo është ora e fundit e ditës së xhuma. I thashë: Si mund të jetë ora e fundit e ditës së xhuma, ndërkohë profeti -alejhi selam- ka thënë: [Nuk rastis në atë moment ndonjë rob mysliman duke u falur] dhe ajo është kohë që nuk lejohet në të falja. Ai më tha: A nuk ka thënë profeti -alejhi selam-: Kush ulet në ndonjë mexhlis duke pritur

*namazin është në namaz derisa sa ta falë atë? I thashë: Sigurisht që po! Ai më tha: Atëherë, kjo është*¹⁶⁰.

E treta: Ora e fundit e ditës së xhuma është edhe ora kur u krijua Ademi -alejhi selam- dhe Allahu i madhëruar i kërkoi melaikeve t'i bien atij në sexhde, siç ka ardhur në një hadith tjetër të Ebu Hurejres -radiallahu anhu- ku thuhet se profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Allahu e krijoi Ademin ditën e xhuma pas ikindisë, në orën e fundit prej orëve të ditës së xhuma mes ikindisë dhe natës (d.m.th: perëndimit të diellit)”¹⁶¹.

Kështu, kjo orë i përshtatet veçorisë më kryesore të ditës së xhuma dhe që është krijimi i Ademit -alejhi selam- babait të njerëzimit dhe prandaj u është dhënë atyre si kohë e pranimit të duasë.

¹⁶⁰ E transmeton Maliku, Ahmedi, Ebu Daudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe e saktëson sheikh Albani.

¹⁶¹ E transmeton Muslimi.



Mosrespektimi i ditës së festës dhe pasojat e tij

Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

ذَلِكَ وَمَنْ يُعْظِمِ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

“**Po. Kush i madhëron shenjat e Allahut** (*d.m.th: shenjat dalluese të fesë së Tij*), ajo është prej devotshmërisë së zemrave”¹⁶².

Në lidhje me fjalën [**shenjat e Allahut**] Imam Kurtubiu -Allahu e mëshiroftë- shpjegon: “*Shenjat e Allahut janë çdo gjë për të cilën Ai ka porositur, apo ka njoftuar dhe vënë në dijeni njerëzit.... Kështu shenjat e Allahut janë shenjat e fesë së Tij*”¹⁶³.

Ndërsa fjala [**madhërim**] nënkupton përkushtimin ndaj tyre për t'i ruajtur ato në mënyrën më të mirë të mundshme, siç bënin sahabët në lidhje me kurbanet, sepse ajeti edhe pse i përgjithshëm, ka ardhur në kontekstin e ajeteve që bëjnë fjalë për kurbanet në ditën e festës së kurbaneve, siç thotë Ibn Abasi -radiallahu anhu- : “*Madhërimi i tyre është të zgjedhësh më të majmen, më të mirën*”

¹⁶² Suretu El-Haxh: 32.

¹⁶³ Shih tefsir El-Kurtubij: 12/56.

*dhe më të madhen*¹⁶⁴. Imam Kurtubiu përsëri sqaron: “Nëse e kryen (detyrën e kurbanit) në këtë mënyrë, edhe pse kryerja mund të realizohet me një tjetër më të ulët në vlerë, atëherë puna e tij nuk ka domethënie tjetër veçse respektimin e fesë dhe kjo është prej devotshmërisë së zemrave”¹⁶⁵.

Pra, Allahu i madhëruar e ka quajtur përkushtimin ndaj shenjave të fesë së tij respekt ndaj saj dhe tregues i devotshmërisë së zemrave të besimtarëve.

Kështu, nëse përkushtimi ndaj shenjave të fesë është devotshmëri, atëherë shkelja e tyre është shturje dhe kapërcim i kufijve (fisk). Allahu i madhëruar, si të tillë e ka cilësuar veprimin e disa prej Beni Israilëve, të cilët shkelën shenjtërinë e së shtunës, festës së tyre.

Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

وَأَسْأَلُهُمْ عَنِ الْقَرْيَةِ الَّتِي كَانَتْ حَاضِرَةَ الْبَحْرِ إِذْ يَعْدُونَ فِي
الْبَسْبِ إِذْ تَأْتِيهِمْ حِيَتَانُهُمْ يَوْمَ سَبْتِهِمْ شُرْعًا وَيَوْمَ لَا
تَأْتِيهِمْ كَذَلِكَ نَبَلُّوهُمْ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ

“Pyeti ata (Beni Israilët) për atë fshatin që ishte pranë detit, kur shkelnin shenjtërinë e së shtunës. Atyre u vinin peshqit ditën e shtunë qartazi ndërsa ditëve të tjera nuk u vinin. Kështu ne i sprovuam ata për shkak se dilnin jashtë kufijve (të Allahut)”¹⁶⁶.

¹⁶⁴ Shih tefsir Et-Taberij: 18/621.

¹⁶⁵ Shih tefsir El-Kurtubij: 12/56.

¹⁶⁶ Suretu El-Earaf: 163.

Fjala e Allahut [**shkelnin shenjtërinë e së shtunës**] tregon se dita e shtunë ishte festë për Beni Israilët dhe atyre u ishte ndaluar puna në këtë ditë për t'u marrë me adhurim. Ibn Kethiri -Allahu e mëshiroftë- citon: “Ata ishin të kapur pas fesë së Teuratit në lidhje me shenjtërimin e ditës së shtunë...., sepse atyre u ishte ndaluar peshkimi në atë ditë dhe gjithashtu të gjitha zanatet, tregtitë dhe çdo gjë fitimprurëse”¹⁶⁷. Ai gjithashtu citon: “Porosia për të ruajtur të shtunën do të thotë: kushtimi i një dite në javë për adhurim, gjë e cila kërkohet edhe për xhumanë, sepse Allahu me atë ka anuluar të shtunën”¹⁶⁸.

Ndërsa Muxhahidi -Allahu e mëshiroftë- në lidhje me fjalën e Allahut [**Kështu ne i sprovuam ata për shkak se dilnin jashtë kufijve** (të Allahut)] thotë: “Kjo sepse ata e morën të shtunën ditë shkeljeje dhe kundërshtimi (në vend që ta merrnin ditë bindjeje dhe përkushtimi)”¹⁶⁹.

Shkelja e shenjtërisë së kësaj dite çoi në dënimin e tyre për t'u shndërruar në majmunë të nënçmuar, prandaj kij kujdes o rob i Allahut në shkeljen e shenjave të fesë së Allahut se kjo punë është me pasoja të rënda. Edhe xhumaja për pozitën që ka në Islam, mosrespektimi i saj ka pasoja të rënda për besimtarët, siç pati edhe mosrespektimi i së shtunës për Beni Israilët. Duke parë në citatet e Kuranit dhe të haditheve profetike, gjejmë se mosrespektimi i saj ka pasoja në lidhje me besimin, moralin dhe jetesën e njerëzve.

¹⁶⁷ Shih fjalët e autorit në librin me titull “El-Bidajeh ue En-Nihajeh”: 2/144.

¹⁶⁸ Shih fjalët e autorit në librin me titull “El-Bidajeh ue En-Nihajeh”: 1/326.

¹⁶⁹ Shih tefsir Ibn Ebij Hatim: 5/1599.

E para: Pasojat në lidhje me besimin shfaqen për faktin se kjo punë vulos zemrën për të qenë gjithmonë i shkujdesur ndaj përkujtimit të Allahut. Profeti -alejhi selam- thotë: **“Ose t’i japin fund ca njerëz lënies së xhumave, ose Allahu do t’jua vulosë zemrat dhe pastaj do të mbeten gjithmonë të shkujdesur”**¹⁷⁰.

Imam Et-Tibij Allahu e mëshiroftë në lidhje me kuptimin e këtij hadithi thotë: *“Kuptimi i këtij hadithi është se njëra nga të dyja do të ndodhë patjetër: ose dhënia fund lënies së xhumave, ose vulosja e zemrës, sepse bërja zakon e lënies së xhumasë bën që të sundojë ndryshku mbi zemër dhe largon dëshirën e shpirttrave për adhurim, gjë e cila i çon pastaj drejt shkujdesjes së përhershme”*¹⁷¹.

Kjo, në një këndvështrim tjetër do të thotë mbjellje e hipokrizisë në zemër, sepse hipokritët (munafikët) janë ata të cilët nuk e përkujtojnë Allahun veçse pak, siç thotë Allahu i madhëruar në Kuran:

وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كُسَالَى يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ
اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا

“Ata (hipokritët) kur ngrihen për në namaz, ngrihen me përtesë sa për t’u dukur dhe nuk e përmendin Allahun veçse pak”¹⁷².

Fjalën hipokrizi e ka përmendur edhe profeti -alejhi selam- në lidhje me lënësin e xhumave dhe thotë: **“Kush lë tre xhuma pa arsye, shkruhet prej hipokritëve”**¹⁷³.

¹⁷⁰ E transmeton Muslimi, Ahmedi, Darimiu, Nesaiu etj.

¹⁷¹ Shih fjalët e autorit në librin Sherh El-Mishkat: 4/1270.

¹⁷² Suretu En-Nisa: 142.

¹⁷³ E transmeton Taberani dhe e saktëson sheikh Albani.

Numri tre në lidhje me lënien e xhumave përmendet edhe në një hadith tjetër ku thuhet: “**Kush e lë xhumanë tre herë me neglizhim pa ndonjë domosdoshmëri i vuloset zemra**”¹⁷⁴.

El-Baxhi (dijetari i njohur andaluzian -Allahu e mëshiroftë-) në komentimin e këtij hadithi thotë: “*Allahu e ka shtyrë vulosjen për në lënien e tretë që t’i japë mundësi njeriut për t’u penduar*”¹⁷⁵.

Shumë prej dijetarëve të islamit mendojnë se kjo pasojë shfaqet nëse robi lë tre xhuma të një-pas-njëshme, sepse në disa versione të tjera të këtij hadithi cilësohet me “**tre herë të një-pas-njëshme**” dhe se lëniet njëra pas tjetrës tregojnë se ai nuk ka interesim ndaj porosive të Allahut.

E dyta: Pasojat në lidhje me moralin shfaqen nga fakti se, në xhuma njeriu merr këshilla dhe udhëzime javore për të cilat ka shumë nevojë të kujtohet me to herë pas here. Ai nëse e pengon veten e tij nga kjo mundësi, atëherë ai do jetë viktimë e dobësisë njerëzore dhe cytjeve djallëzore të cilat do t’ia prishin atij moralin, sjelljen dhe kulturën.

E treta: Pasoja në lidhje me jetesën shfaqen nga fakti se Allahu i madhëruar e ka lidhur respektimin e shenjave të fesë së Tij edhe me riskun dhe begatinë.

Allahu i madhëruar në Kuran thotë:

وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْقُرَىٰ آمَنُوا وَاتَّقَوْا لَفَتَحْنَا عَلَيْهِم بَرَكَاتٍ مِّنَ السَّمَاءِ
وَالْأَرْضِ

¹⁷⁴ E transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe, Nasai etj dhe e saktëson sheikh Albani.

¹⁷⁵ Shih fjalët e autorit në librin El-Munteka: 1/204.

“Sikur banorët e vendeve te besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, do t’u dërgonim begati nga qielli dhe toka”¹⁷⁶.

Ibn El-Kajim -Allahu e mëshiroftë- thotë: *“Kundërshtimet e Allahut fshijnë begatinë. Prej pasojave të tyre është se ato fshijnë begatinë e jetës, begatinë e riskut, begatinë e dijës, begatinë e punës, begatinë e adhurimit. Pra, në përgjithësi ato fshijnë begatinë e fesë dhe të dynjasë... Nuk është penguar begatia e qiellit dhe e tokës veçse prej gjynaheve të krijesave”¹⁷⁷.*

Prej mirësisë së Allahut në lidhje me këtë ymet është se profeti -alejhi selam- është dërguar me fenë e drejtë dhe të lehtë siç thuhet në hadith: **“Nuk jam dërguar me jehudizëm dhe as krishterizëm por jam dërguar me fenë e drejtë dhe të lehtë”¹⁷⁸.**

Kjo mirësi e Allahut të madhëruar, në lidhje me këtë ymet, shfaqet edhe në lidhje me xhumanë, sepse Allahu i madhëruar nuk ka i kërkuar atij gjithë ditën e xhuma, por vetëm kohën nga thirrja e ezanit të ditës së xhuma deri në faljen e namazit të saj. Ndërsa Beni Israilëve, siç duket nga çfarë u përmend më lart, është se shenjtëria e së shtunës në ligjet e tyre përfshinte të gjithë ditën. Prandaj le t’i shfrytëzojë ky ymet këto mirësi: mirësinë e xhumasë, mirësinë e begative të saj dhe mirësinë e fesë së lehtë për t’u lumturuar në dynja dhe në ahiret.

¹⁷⁶ Suretu El-Araf: 96.

¹⁷⁷ Shih fjalët e autorit në librin El-Xheuab El-Kafij: 84.

¹⁷⁸ E transmeton Ahmedi, Taberani dhe e saktëson sheikh Albani.



Dr. ABDULLAH NABOLLI

XHUMAJA

Festa e Myslimanëve